

albISLAM

revistë e përmuajshme fetare kulturore shkencore

Bajrami - rregulla dhe dispozita

■ **Faqe 17**
**Hipnoza nga
këndvështrimi
Islam**

■ **Faqe 23**
**Pesë gjërat,
që e shkatërrojnë
zembrën**

■ **Faqe 54**
**Sadakatul
fitri**

ISSN 1409-6250



91771409625002

Kryeredaktor:
Omer BERISHA

Redaksia:
Bekir HALIMI, Talha KURTISHI,
Muhamed DËRMAKU, Agim BEKIRI,
Alaudin ABAZI, Ali SHABANI,
Lulzim SUSURI, Enver AZIZI,
Ulvi FEJZULLAHU

Bashkëpunëtorë:
Ekrem AVDIU, Ismail BARDHOSHI,
Enis RAMA, Ahmed KALAJA, Fadil MUSLIU

Redaktor gjuhësor:
Fatmir Baçi
Redaktor teknik & faqosës:
Halil BERISHA
Redaktor artistik & disenji:
Azem ZAIMI

Botues:
Metush MEMEDI

Adresa:
rr: 110 nr: 5, Çarshia e vjetër
Shkup 1000
e-mail: albislam@gmail.com
sms: +389 75 436 718
tel & fax: +389 2 3230 827

Revista është e regjistruar
pranë Agjencisë për Informata
të Maqedonisë nr. 02-124/2
ISSN: 1409-6250

Tirazhi: 1500

ABONIMI NJËVJEÇAR
Për Maqedoni: 600 den, Evropë: 20 €,
Kanada dhe Amerikë: 40 €
(në çmim janë të përfshira edhe
harxhimet postare)

NUN-R DOOEL
Xhirollogaria: 300000001759616
Komerçijalna Banka A.D. - Skopje (denar)
Xhirollogaria: 0270100209184
Komerçijalna Banka A.D. - Skopje (euro)
Rr. "Kej Dimitar Vlahov" 4
S.W.I.F.T. : KOBSMK2X
IBAN MK07300701002091869
Numri tatimor: 4030003487017

alb
ISLAM
DEL NË FILLIM TË MUAJIT

FOCUS
print
E-mail: fokusprint@mt.net.mk

TEL.: 02 2600 400; 2601 638; FAX 02 2601 639
MOB. 075 275 939; 075 451 813

Bëjmë shtypjen dhe përpunimin e:

- Vizitë-kartelave
- Kalendarëve
- Ftesave
- Pllakateve
- Flaerave
- Materialeve të ndryshme
- Katalogëve
- Librave

Risi: Shtypim edhe me kopertina të forta



Lamtumirë Ramazan

3

Prehjes nën hijen e Ramazanit dalëngadalë po i afrohet fundi. Shpirtrat sado që ngazëllehen në pritje të festës sërisht ndiejnë një mangësi në vete, ngase po ndahen nga një mik shumë i dashur. Kjo ndarje do të lehtësohej sadopak sikur të ishim prej fitimtarëve të Ramazanit, sikur fjalën e lamtumirës muajit të bekuar t'ia shprehnim faqebardhë.

Sa herë që i vije fundi këtij muaji më kujtohen një ajet kur'anor dhe një hadith pejgamberik dhe pyetem: vallë cila është pozita ime dhe e vëllezërve të mi në raport me këto fjalë të shenjta.

“O ju që besuat, agjërimi u është bërë obligim sikurse që ishte obligim edhe i atyre që ishin para jush, kështu që të bëheni të devotshëm.” (Bekare: 183)

Ramazani është një shkollë në vete dhe ka një synim madhor. Ai mëton të na bëjë më të devotshëm. Është një mundësi shumë e përshatshme për t'i rikthyer vetvetes që më pas të hyjmë tërësisht në fenë e Allahut. T'i rregullojmë raportet tona me Allahun duke iu nënshtruar Atij, me vetveten duke e pastruar shpirtin dhe me njerëzit tjerë duke pasur qëndrim korrekt dhe moral të lartë.

Është shumë tragjike nëse ky adhurim madhështor përjeton një qasje të përciptë, një vështrim të ngushtë që s'i tejkalon kufijtë e nevojave fizike të njeriut për të ngrënë, për të pirë e kënaqur. Një qasje e këtillë nuk do të na kishte rezultuar me diçka më shumë se një përjetim urie e pakuptimtë.

Mendoj se çdo musliman duhet të bëjë një vetëllogaritje, të analizojë gjendjen e tij dhe të shohë sa ka përfituar nga Ramazani, sa kanë ecur përpara përpjekjet e tij për t'u përmirësuar.

Pejgamberi, lavdërimi dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, thotë: ***“Është i përbuzur (e përsërit tri herë)! Pyetën: kush o i Dërguar i Allahut? Tha: ai që arrin Ramazanin dhe nuk i falen mëkatet.”***

Mbi të gjitha duhet të përpiqemi të arrijmë kënaqësinë e Allahut, faljen dhe mëshirën e Tij. Të kujdesemi që veprat tona të pranohen tek Allahu i Madhëruar edhe atë duke vazhduar me adhurime e bindje ndaj Allahut edhe pas përfundimit të ibadeteve madhështore. T'i themi lamtumirë Ramazanit dhe sërisht t'i përvelim krahët në adhurime tjera: ***“E kur ta kryesh (obligimin), atëherë sërisht rreku (adhurimeve tjera).*** (Inshirah: 7)

Në emër të redaksisë: Agim BEKIRI

EDITORIAL

alB ISLAM

- Faqe 5** Pozita e muslimanëve në hartën digjitale bashkëkohore

- Faqe 10** Drejtësisë zëri po i dëgjohet, puna nuk po i shihet!

- Faqe 14** Shndërrimi i të këqijave në të mira

- Faqe 17** Hipnoza nga këndvështrimi Islam - ndërmjet lejimit dhe ndalimit

- Faqe 23** Pesë gjërat, që e shkatërrojnë zemrën
Faqe 28 Ruajtja e besimit/fesë

- Faqe 33** Bajrami rregulla dhe dispozita

- Faqe 38** “SadekAallahulAdhim”

- Faqe 40** Gruaja — mes liberalizmit ekstrem dhe radikalizmit të pa bazë

- Faqe 46** Harry Potter- një analizë islame e këtij fenomeni
Faqe 49 Gruaja e ditur e udhëzuar- krenaria e një populli

- Faqe 53** “Kam harruar të martohem”

- Faqe 54** Sadakatul fitri (zekatul-fitri)

- Faqe57** Veprat që të nxjerrin nga Islami (2/2)

- Faqe 60** “Mëkatet e mëdha”

Pozita e muslimanëve në hartën digjitale bashkëkohore

D-r. Muhamed JUNUS



I gjithë revolucioni i sotshëm digjital ngrihet në idenë e bazimit mbi dy numra: zero dhe një, apo “njëshet dhe zerot”, në atë mënyrë duke shndërruar çdo informatë në vlerë digjitale, e cila plotësohet nëpërmjet aparateve teknike dhe llogaritëse, ndërsa qarkullimi i të njëjtave mundësohet nëpërmjet revolucionit të telekomunikacionit. Ndoshta muslimanët e sotit e kanë borxh t’i lexojnë mëshirë el-Havarizmit, sepse ai shpiku “zero-n”, ai bëri që bota digjitale

të jetë meritë e muslimanëve, por fatkeqësisht në një kohë të prapambetjes morale e qytetare.

Mirëpo mendja muslimane ndaloi zbulimet dhe kjo u shpërngul te dikush tjetër, të cilët fituan shumë nga ky dhe zbulime tjera shkencore të muslimanëve.

A thua vallë sot, në kohën numerike, muslimanët do të marrin në konsideratë el-Havarizmin, duke ndërruar pozicionin e tyre nga konsumatorë në prodhues?

Ata që përgatisin kulaçin e shoqërisë

Artikujt e paraqitur në këtë rubrikë janë mendime dhe komente personale të autorëve dhe nuk korrespondojnë patjetër me atë që redaksia i di për të vërteta

Aktuale

së informatikës, derës së botës digjitale, theksojnë se çështja nuk qëndron në atë se duhet zhvilluar dhe shtuar përdorimin e teknologjisë dhe aparateve të ndryshme. Çështja në rend të parë është sfidë, që personifikohet në zhvillimin dhe përparimin e ambientit në tërësi, përfshirë këtu edhe ligjet, rregullat

dhe politikat. Ashtu që, çdo sektor ku gatuhet një politikë duhet t'i ketë parasysh këto dhe në mënyrë aktive duhet të merr pjesë në ridefinimin e ecursisë së veprimtarisë në aspektin politik. Dhe atë, duke filluar nga politika arsimore dhe shoqërore, nga ajo e telekomunikacionit, prodhimit dhe tregtisë, e po ashtu edhe nga politika e përparimit dhe aplikimit të të drejtave, lirive dhe sigurisë. Të gjitha këto elemente së bashku me të gjitha sektorët, duhet të ngrihen në shkallë gjithëkombëtare, të jenë brenda politikës së përgjithshme dhe ecursisë së veprimtarisë së përbashkët, që pastaj të kenë mundësi për të paraqitur një strategji të pjekur për shoqërinë e informatikës, brenda një pikëpamje të përgjithshme largpamëse.

Thelbi i kësaj kohe është mundësia e përfitimit nga informatika, zhvillimi i saj dhe aktivizimi i hulumtimeve shkencore. Këto tani, kanë shumë përparësi para forcës njerëzore, madje edhe para asaj materiale. A thua vallë, në çfarë pozite qëndron shkenca arabe dhe islame në këtë aspekt? Sidomos, duke marr parasysh se arsimi dhe hulumtimi shkencor numërohen si mjetet më të dalluara dhe thelbësore në ndërtimin e

Në Amerikë në vitin 1999, buxheti për hulumtime dhe zhvillim vlerësohet me 15 herë më shumë sesa shpenzon gjithë bota arabe së bashku për hulumtime dhe zhvillim.

forcës njerëzore që ka të bëjë me përfshirjen e njohurive dhe përhapjes së tyre. E të mos flasim për atë se sa mjet efikas janë këto për përfitimin e shkathtësive për bashkëveprim pozitiv me revolucionin digjital.

Statistikat e bankës botërore në vitin 1999 për përqindjen e shkencëtarëve

dhe inxhinierëve në 1 milion njerëz, që punojnë në sferën e hulumtimit dhe zhvillimit, janë si vijon (brenda viteve 1985 – 1995): në disa shtete të muslimanëve: Egjipt – 458; Malezi – 87; Saudi – 29; Pakistan – 4. Ndërsa kjo përqindje në vendet e njohura me prodhim është si vijon: Japoni – 6309; Kombet e bashkuara – 3732; Australi – 3166; Gjermani – 2843. Ky dallim, dita ditës bëhet edhe më i madh.

D-r. Ishfaq Ahmed, nga komisioni i forcës bërthamore të Pakistanit, në një studim të rëndësishëm me titullin: *“Kultura e hulumtimit dhe zhvillimit në botën islame, mes të kaluarës, problemeve të sodit dhe planeve të ardhmes”* thekson se shkencëtarët tanë, kanë mundësi të bëjnë tërë atë që na nevojitet, por mungon vullneti i fortë dhe i vazhdueshëm politik dhe qartësia e qëllimeve. Shkencëtarët muslimanë kanë mundësi t'i përballojnë çdo sfidë shkencore dhe teknike në çdo vend. Po ashtu shumë prej tyre kanë aftësi të hartojnë strategjitë e atdheut të tyre në këtë sferë.

Këtë e sqaron ajo se banorët e shteteve anëtare në **Konferencën e shteteve Islamike** janë 20% nga tërësia e banorëve të planetit, mirëpo

prej tyre vetëm 6.7 milion njerëz punojnë në *hulumtime dhe teknologji*, numër i cili është i barabartë me më pak se 4% nga numri i studiuesve në botë. Ndërsa, sa i përket përqindjes së forcave aktive në *hulumtime dhe zhvillim* në botën Islame, ajo është më pak se 1% nga numri i studiuesve në botë.

Problemi me siguri fshihet në atë se shumica jonë, ende nuk e ka kuptuar se pasuria e vërtetë nuk është vetëm pasuria natyrore, por është pasuria njerëzore shpikëse (zbuluese) dhe sistemi arsimor, i cili do t'i ngrinte qytetarët e shteteve tona në një shkallë të lartë shkencore dhe teknologjike.

Një gjë tjetër, që tregon realitetin e pozitës së botës Islame shihet në faktin se prodhimi vendor i botës Islame, përfshirë këtu 56 shtete, vlerësohet me 1200 miliard dollarë në vjet. Ndërsa vlera e prodhimit vendor vetëm në Francë, për një vjet është 1500 miliard dollarë, në Gjermani 2500 miliard dollarë, në Japoni 2500 miliard dollarë, ndërsa në shtetet e bashkuara 4500 miliard dollarë.

Siç po shihet, këto numra janë frikësues! Këtu po bëjmë pyetjen: Pse të jetë kjo ulje e madhe në vlerën e prodhimit vendor në botën Islame, në të cilën jetojnë një e katërta e banorëve të planetit, ku gjenden 70% të rezervave të naftës dhe shumë përqindje të larta tjera nga pasuri të ndryshme. Mirëpo, krahas gjithë kësaj, përfshirë të gjitha shtetet muslimane, nuk prodhojnë më shumë se sa gjysma e prodhimit të

Gjermanisë, apo sa një e katërta e prodhimit të Japonisë?!

Përgjigja është e thjeshtë: Shtetet industriale nga buxheti i tyre shpenzojnë 3-5% në shkencë dhe teknologji, ndërsa shtetet muslimane në këtë sferë, prej buxhetit të tyre ndajnë më pak se 1%. Ndodhë që buxheti i vetëm një universiteti në Amerikë të jetë i afërt me buxhetin e shkencës dhe teknologjisë të një shteti apo të disa shteteve muslimane së bashku.

Është patjetër të aktivizohet roli i atyre komisioneve, të cilat u themeluan pas *Tubimit të Tretë të kryetarëve* të shteteve muslimane, në Mekë 1981. Aty është vendosur që ato komisione të punojnë në hartimin e politikës dhe programeve për përfundimin e bashkëpunimit shkencor midis shteteve muslimane. Siç thotë D-r Ishfak, se shtetet muslimane kanë bërë shumë tubime dhe konferenca për bashkëpunim shkencor dhe atë, në shumë sfera dha nga pikëpamje të ndryshme. Shpresonim që rezultati të jetë 10% nga ajo që flisnin. Problemi nuk është te shkencëtarët, studiuesit dhe inxhinierët, sepse ata janë këtu dhe të gatshëm për çdo punë, problemi është te vullneti politik, sepse politikanët nuk i ndihmojnë shkencat më shumë sesa “ndihma e buzëve” nëpër ligjërimet e tyre.

Mirëpo, krahas gjithë kësaj, përfshirë të gjitha shtetet muslimane, nuk prodhojnë më shumë se sa gjysma e prodhimit të Gjermanisë, apo sa një e katërta e prodhimit të Japonisë?!

Sa i përket shpenzimeve në arsim në botën arabe; shtetet arabe në arsim shpenzojnë më shumë se shumë vend tjera nëse e kemi parasysh produktin vendor, sepse përqindja e shpenzimeve në arsim, në

Problemi me siguri fshihet në atë se shumica jonë, ende nuk e ka kuptuar se pasuria e vërtetë nuk është vetëm pasuria natyrore, por është pasuria njerëzore shpikëse (zbuluese) dhe sistemi arsimor

botën arabe arrin deri në 1.5% nga produkti vendor, në vendet shumë të zhvilluara ky shpenzim arrin deri në 8.3% ndërsa në vendet e përparuara ky shpenzim arrin deri në 2.5%. Edhe pse leverdia nga arsimit, në zhvillimin njerëzor numërohet si një nga leverditë më të vogla.

Studiuesi i dalluar, Anton Zahlan, në studimin "Arabët dhe sfidat e shkencës dhe teknologjisë" na sqaron realitetin e qëndrimit arab ndaj arsimit dhe hulumtimit, ku përmend se në vitin 1995, repartet e shkencave teorike dhe praktike në universitetet arabe, përbënin një trup prej 50 000 anëtarëve, prej të cilëve 32 000 kishin doktoraturë, në shkenca të ndryshme dhe teknologji.

Po ashtu kishte edhe më shumë se një mijë organizata arabe, të cilat kanë botuar ndonjë studim apo edhe më shumë gjatë vitit 1995. Mirëpo ka mundësi që numri dhe cilësia e këtyre organizatave të shtohet shpejt, nëse u përmirësohen financat, menaxhohen mirë dhe shpeshtohen kërkesat për ofertat të tyre.

Vendet arabe nga zhvillimi i fuqisë aktive në prodhim, universitete, hulumtim dhe përparim kanë fituar pasuri të hatashme. Në fuqinë punuese arabe, që përbën 84 milion njerëz (në vitin 1997) kishte përafërsisht 10 milion të diplomuar universitar, 35% prej të cilëve

kishin diplomë bachelor, ose edhe më lartë, pavarësisht në shkencat teorike apo praktike.

Nga viti 1950, kur universitetet arabe ishin vetëm 12, në vitin 1995 kërcyen në 175 universitete. Po ashtu, gjatë dhjetë viteve të fundit u themeluan afër 40 universitete private, në të cilat universitete mësojnë gjithsej 3 200 000 studentë (në vitin 1995-96), prej të cilëve dy milion e gjysmë mësojnë në shkallën bachelor.

Mirëpo, prapë se prapë, shpenzimi në hulumtime shkencore ka ngelur pak, në krahasim me botën e përparuar, ku shpenzimi për hulumtime dhe zhvillim është duke kaluar edhe nivelet më të larta. P.sh. në Amerikë në vitin 1999, buxheti për hulumtime dhe zhvillim vlerësohet me 15 herë më shumë sesa shpenzon gjithë bota arabe së bashku për hulumtime dhe zhvillim. Kjo jep të kuptosh se sa e madhe është zbrazëtia jonë në zhvillimin dhe përparimin e mirëfilltë.

Sot, në botën arabe ka më shumë se 100 000 zyra për konsultim dhe ndërmarrje kontraktimi, 10 milion të diplomuar universitar, 700 000 inxhinier arab, qindra ndërmarrje gjigante prodhuese (kam për qëllim ato ndërmarrje

Ata që përgatisin kulaçin e shoqërisë së informatikës, derës së botës digjitale, theksojnë se çështja nuk qëndron në atë se duhet zhvilluar dhe shtuar përparimin e teknologjisë dhe aparateve të ndryshme. Çështja në rend të parë është sfidë

që posedojnë kapital prej disa miliardave dollarë), 50 000 anëtarë në repartet arsimore universitare, nga shkenca dhe teknologjia, të cilët punojnë në 175 universitete, si dhe 1000 shoqata të cilat janë aktive në hulumtime dhe zhvillim.

Krahas kësaj pasurie, vendet arabe prapë se prapë nuk po tregojnë aftësi për të shfrytëzuar si duhet shkencën dhe teknologjinë që i mundësohet, pse?

Anton Zahlan jep mendimin se unionet për shkencë dhe teknologji janë unione të përbëra nga rrjete, ndërsa aktiviteti shkencor mbrohet me veçoritë *e pjesëmarrjes së mirëfilltë dhe mbikëqyrjes së urtë*, gjëra të cilat lidhen ngushtë me realizimin e suksesshëm, duke theksuar se këto lloj rrjete nuk mund të themelohen me një politikë ekonomike me nepotizëm, njëjtë sikur një vend që nuk mundet të shfrytëzojë të mira dhe mundësi nga përgatitja shkencore dhe teknologjike, po nuk e zhvilloi unionin kombëtar për shkencë dhe teknologji.

Unione kombëtare për shkencë dhe teknologji ka mundësi të themelohen vetëm nëse braktiset kultura e politikës së nepotizmit. Realisht, vazhdimësia e marrëveshjeve për projekte të gatshme, të zbrazëta krejtësisht nga teknologjia, kanë bërë që nepotizmi të përhapet në të gjitha vendet arabe. Me fjalë tjera, bota arabe ka punuar që të shtojë forcën punuese, mirëpo ende nuk i ka të qarta politikat që inkurajojnë në themelimin e

Thelbi i kësaj kohe është mundësia e përfitimit nga informatika, zhvillimi i saj dhe aktivizimi i hulumtimeve shkencore. Këto tani, kanë shumë përparësi para forcës njerëzore, madje edhe para asaj materiale. A thua vallë, në çfarë pozite qëndron shkenca arabe dhe islame në këtë aspekt?

unioneve për punësim efektiv dhe rezultues.

Kjo bëhet edhe më e qartë, kur të kuptojmë se vendet arabe gjatë dyzet viteve të fundit kanë përfituar më shumë se 3000 miliard dollarë, nga kapitali i përgjithshëm. Por, kjo është gati 25% nga produkti i përgjithshëm kombëtar, në botën arabe. Këtu kuptojmë se produkti i përgjithshëm lokal është i vogël në mënyrë ekstreme. Ky realizim i dobët kthehet te mungesa e unioneve kombëtare për shkencë dhe teknologji.

Raporti i zhvillimit arab për humanizëm (2002), na bën të qartë se programi për hulumtime dhe zhvillim në rajon ka nevojë të caktojë qëllimet në pajtim me mundësitë e dhëna, të ndikojë në situatat lokale dhe ndërkombëtare mbi rajonin si dhe të caktojë aspektet e përqendrimit hulumtues, ashtu që të përfshijë temat themelore që kanë përparësi në rajon.

Operacioni i caktimit të qëllimeve është element kryesor për strategjitë dhe politikën e hulumtimit dhe zhvillimit. Nuk ka mundësi, që shtetet e dobëta, të varfra dhe të prapambetura shkencërisht, të aktivizohen dhe të dallohen në sfera të ndryshme të hulumtimit, ato mund të dallohen vetëm në disa sfera dhe atë, me kusht që tërë mundësitë të koncentrohen në atë hulumtim. Këtë e themi sidomos kur i kemi parasysh mundësitë materiale dhe njerëzore të vogla, të kufizuara dhe modeste në vendet arabe, po ashtu edhe

rezultati i hulumtuesve në ato vende përbën më pak se 1% nga rezultati botëror. Andaj, patjetër është që hulumtuesit të specializohen në sfera të ndryshme dhe të kenë qëllim me projektet e tyre: sjelljen e dobisë më të madhe për shoqërinë e tyre.

Raporti propozon që programi për hulumtime dhe zhvillim të koncentrohet në *qendrat për epërsi lokale*, sepse suksesi botëror është patjetër të fillojë dhe të zhvillohet nga ai lokal.

Duhet tu jepet shumë rëndësi sferave të atilla për epërsi, shtetet arabe duhet të hartojnë qëllimet për veprimtari në ato sfera ku mund të dallohen për të mirë dhe sukses në shkallët më të larta, të dijës dhe njohurive në botë. Duhet të koncentrohen forcat në ato sfera që kanë leverdi ekonomike, sikur në agronomi, ujë, energji solare si dhe prodhimtaritë gjigante petrokimike dhe fosfatike. Po ashtu duhet të koncentrohen në programe të ndryshme dhe informatikë, duke i dhënë rëndësi edhe atyre sferave që kanë nevojë për elementin njeri, më shumë sesa për elementin mundësi materiale. Me fjalë tjera, duhet të koncentrohen në shkencat që njihen me emrin shkencat ekzakte, së bashku me informatat dhe temat për hulumtim që gjenden në to, sikurse në shkencat teorike, si matematika, fizika dhe ekonomia, po ashtu edhe ato të cilat mund të aktivizohen me prodhim të caktuar.

Përktheu: Omer Berisha

Drejtësisë zëri po i dëgjohet, puna nuk po i shihet!

Shkruan: Blerim MUHAXHERI

Drejtësia si një ndër faktorët kyç për mirëmbajtjen e rendit dhe qetësisë shoqërore, është ndër çështjet me rëndësi dhe peshë të madhe në Islam. Ajo krijon harmoni në zemrat e njerëzve dhe dashuri reciproke mes tyre. Drejtësia formon shoqëri të qëndrueshme dhe vendos në të themele të shëndosha. Me të, njerëzit orientohen kah e mira dhe e dobishmja. Ajo është



çelësi i sukseseve dhe përparimeve në jetë. Drejtësia është kulmi i respektit ndërnjerëzor dhe zbatim praktik i urdhrat të Allahut.

Me anë të kësaj cilësie madhështore, gjeneratat e para arritën famë dhe autoritet. Drejtësia kishte zënë vend dhe ishte mishëruar në zemrën dhe shpirtin e tyre. Çështjet e konfliktit dhe mosmarrëveshjes që i kishin apo u ndodhnin në jetën, i pastronin me anë të saj. Ishin të drejtë ndaj çdokujt, bile edhe ndaj të huajve. Ndodhte, që për hir të së Vërtetës dhe drejtësisë të gjykonin në favor të huajve sesa të pjesëtarëve të vet. Kjo cilësi i ngriti në shkallë

të lartë të besimit dhe edukatës dhe i pastroi nga cilësitë e këqija. Drejtësia për ta ishte siç është hija për njeriun – veti e pandashme e tyre. Me drejtësi punuan në jetën e tyre, rezultat i së cilës gjysma e botës ra nën sundimin e

tyre. Ajo dha pasqyrë të bamirësisë e cila u reflektoi në veprat dhe sjelljet e tyre. Dhe se në frymë të kësaj cilësie rritej fëmija dhe plakej i moçmi apo thënë ndryshe, kjo cilësi trashëgohej nga plaku tek i riu.

Mirëpo, kalimi i kohës dhe ardhja e gjeneratave të reja solli një pasqyrë të re në shoqëri. Pasqyrë që nuk po na kujton në asgjë të përbashkët me atë që

E ajo është se "therësi" është i drejtë dhe i pafajshëm, kurse viktima është fajtores, pra Serbia doli me flamurin e drejtësisë dhe pafajësisë, kurse populli boshnjak mbeti me lot në sy për humbjen e të afërmeve të tyre.

ka ekzistuar më herët. Njerëzit u zhveshën nga cilësitë e mira dhe në vend të tyre u pajisën me cilësi të këqija. Shoqëria mori një kahje të gabuar në jetë, u orientua kah “përparimi” dhe “suksesi” e veçanërisht shoqëritë e vendeve sunduese në aktivitetet e tyre që i kanë ndaj popujve që i sundojnë. Interesi e zuri vendin e sinqeritetit në ndihmën që ua bëjnë atyre. Drejtësia po mbetet vetëm fjalë goje apo shënim nëpër dokumentet e tyre. Së paku kështu po shihet nga pamja e jashtme, e nëse ia fshijmë pluhurin kësaj fjale do ta shohim se shkruan: DREJTËSI me prefiksin PA.

Pra, drejtësia është duke rënë nga përdorimi. Për të vetëm po flitet, kurse me të asgjë nuk po punohet. Të gjitha mbledhjet që po mbahen, po bisedojnë për drejtësi, kur po vjen puna të punohet me të, ajo nuk njihet. Synimet të gjithë i kanë të orientuar kah drejtësia, kurse veprimet e tyre i kanë në kundërshtim me të. Thënë shkurt, drejtësinë për të cilën po na flasin ata, ne në fjalorin tonë e njohim si antonim të drejtësisë.

Ja, çështja e luftës së Bosnjës e veçanërisht masakrat e Srebrenicës janë fakt dhe dëshmi e gjallë se si ata e zbatojnë drejtësinë. Para syve të SFOR-it holandez u masakruan gati 8000 myslimanë. Askush nuk u doli në ndihmë e as që të pengojë diçka. “Ndihmësit” holandezë ishin aty, por sikur të mos kishin qenë fare. U pa “ndihma” e tyre dhe qëllimi pse kanë ardhur. U derdh gjaku i popullit bosh-

njak nga dora e egër e serbit dhe askush nuk “ngriti pluhur” për këtë vepër. Ndihma erdhi për mbajtjen e kufomave që të varrosen, kur ishte në pyetje shpëtimi i jetës ndihma nuk ekzistonte. 8000 myslimanë përjetuan vdekjen para atyre që kishin ardhur që t’i shpëtonin. Tani, cilët janë zullumqarë më të mëdhenj, ata që masakruan apo ata “që ndihmuan”? Pyetja mbeti e hapur një kohë e gjatë, thujse një dekadë. Askush nuk jepte përgjigje për të. Zëri dëgjohej vetëm te familjet e viktimave, tek ata që qanin dhe vajtonin të hum-

burit e tyre, mirëpo, edhe pas gjithë kësaj, ata e orientuan sërish shpresën tek Zoti, që Ai t’i bashkojë me të humburit e tyre në botën tjetër.

Çështja e masakrës së Srebrenicës la gjurmë të thella pikëllimi në zemrën e popullit boshnjak në veçanti dhe të myslimanëve në përgjithësi. Të gjithë u prekën dhe u tronditën nga ky akt çnjerëzor, ngase ishte

fundi i luftës dhe pritej paqja. Mirëpo, mu në këtë moment ndodhi ajo më e tmerrshmja, “kasapi” therte, kurse “blerësi” e shikonte viktimën. Pra, i pamëshirshmi e realizonte dëshirën dhe e kënaqte shpirtligësinë e vet, kurse “ndihmësi” shikonte “serialet” e masakrave nga njëra viktimë në tjetrën.

Ky tmerr e mbuloi Srebrenicën, i dha pamje mjeruese dhe pikëlluese. Kurse, nga ana tjetër, “Drejtësinë Ndërkombëtare” e kaploi një tmerr edhe më i madh dhe e shpалosi një të

Ndihma erdhi për mbajtjen e kufomave që të varrosen, kur ishte në pyetje shpëtimi i jetës ndihma nuk ekzistonte. 8000 myslimanë përjetuan vdekjen para atyre që kishin ardhur që t’i shpëtonin.

vërtetë tjetër lidhur me këtë çështje.

Pra, “Drejtësia Ndërkombëtare” apo Gjykata e Hagës erdhi me një gjykim të çuditshëm rreth masakrave të Srebrenicës. Një vendim që nuk ka mbështetje as në logjikë e as në argument. Me një gjykim që është i pakapshëm dhe i pakuptueshëm për mendjen e shëndoshë të njeriut. E ajo është se “therësi” është i drejtë dhe i pafajshëm, kurse viktimja është fajtoare, pra Serbia doli me flamurin e drejtësisë dhe pafajësisë, kurse populli boshnjak mbeti me lot në sy për humbjen e të afërmeve të tyre.

Ja, “Drejtësia Ndërkombëtare”, çfarë drejtësie zbaton në gjykimet e veta. Zullumqarin e konsideron të drejtë, kurse viktimën fajtoare. Të fortit i mban krahun, kurse të dobët i kthen shpinën. Kur është në pyetje i fuqishmi, gjykimet nuk maten me vagën e drejtësisë, kurse kur gjykohet i dobëti, argumenti bëhet gënjeshtër. Dhe se për të fortin drejtësia nuk vlen, e kur është në pyetje i dobëti, ajo zbatohet.

“Drejtësia Ndërkombëtare” nuk vlen edhe në një aspekt tjetër. Me një çështje që është shumë e rëndësishme për ne. E ajo është se kur është në pyetje myslimani drejtësia për të nuk vlen. Drejtësi për myslimanin nuk ka, padrejtësia gjykon ndaj tij apo atë e nxjerrin fajtor. Për të argumentet marrin kahje tjetër, padrejtësia zë vendin e drejtësisë. Ai çdoherë mbetet fajtor dhe i akuzuar. Dëshmitë e tij nuk kanë vlerë, edhe pse janë të vërteta, përsëri nuk i pranojnë. Ai është dhe mbetet viktimë e fajit kudo që të jetë dhe për çfarëdo që të gjykohet. Nuk është i barabartë para gjyqit, edhe pse vagat simbolizojnë drejtësinë, ajo për myslimanin nuk vlen.

manin nuk vlen.

Mirëpo, ajo që është me rëndësi është se ata këtë nuk e shprehin hap-tazi. Na paraqiten të drejtë dhe ndihmës, çlirues dhe paqedashës. Por, me genë hipokrit dhe çdoherë me punuar me intrigat e tij, është e pamundur që ajo të mbetet çdoherë sekret, do të vijë koha që ajo të dalë në shesh. Ja tani i padrejti dhe zullumqari e shpaloji fytyrën e tij të vërtetë, doli në shesh pamja e tij reale dhe u paraqit figura e tij e drejtë.

Populli thotë; “Ujku, ujkun nuk e han”, kjo thënie sot po zë vend, e shikuar në dy aspekte:

a) armiqtë e ruajnë njëri-tjetrin kur është në pyetje çështja kundër myslimanit dhe se veten nuk e lënë që të bien viktimë e tij apo fajtor ndaj tij, dhe

b) po të vepronte sipas drejtësisë “Drejtësia Ndërkombëtare” do të duhej që të gjykonte kundër popullit të vet, mirëpo këtë nuk e bënë, ngase nuk lënë që të hyjë ndokush “midis mishit dhe thoit”.

Pra, kjo është drejtësia që zbatohet sot. Për myslimanin drejtësia nuk vlen, ai çdoherë është fajtor. Kurse zullumqari me fajin e vet, del i pastër. Populli thotë: “Faji është jetim”, mirëpo sot nuk po ndodh ashtu, faji po i takon myslimanit, ngase “drejtësia” po gjykon “drejtë”.

Na mbetet që të themi se drejtësia qenka primare vetëm në bisedë, kurse kur nevojitet zbatimi, ajo nuk ekziston dhe se drejtësisë vetëm po i dëgjohet zëri, kurse puna nuk po i shihet.

Shndërrimi i të këqijave në të mira



Shkruan: Ulvi FEJZULLAHU

Lartësuar dhe i lavdëruar qoftë Allahu, i cili zbriti të vërtetën, Kur'anin, robit të Tij Muhamedit, salAllahu alejhi ve selem, që të jetë këshillues, qortues, udhëzues, përmirësues për mbarë njerëzimin deri në fundin e kësaj bote, në ditën e gjykimit.

Të nderuar lexues!

Kur'ani, burimi i pashtershëm i mirë-sive, kuptimi dhe domethënia e tij nuk njohin fund. Një ajet në suren Furkan, ajeti 70, më shtyu të ndalem dhe të mendoj mbi madhësinë e pendimit dhe faljes, besimin në njëshmërinë së Allahut të Lartësuar dhe veprën e mirë.

Ata që kanë konfirmuar pendimin në këtë botë me sinqeritetin më të madh, ata janë dhe veprojnë si besimtarë të denjë. Këta janë kthyer te Allahu

Fuqiplotë, që i pranon në pendimin e tyre, i lehtëson dhe u siguron një fund të mirë. Përpara se të besonin, ata kishin vepruar dhe ushtruar mëkate dhe gjynahe të shumta, porse, në momentin që fituan statusin e besimtarit të sinqertë, Allahu i shndërroi gabimet e tyre në të mira.

Së bashku ta lexojmë ajetin:

“Përveç atij që është penduar dhe ka bërë vepër të mirë, të tillëve Allahu të këqijat ua shndërron në të mira. Allahu është mëshirues, andaj Ai falë shumë.” (Furkan, 70)

Duhet të ndalemi dhe të mendojmë në këto mirësi, në faljen e Allahut të Lartësuar dhe në mëshirën e Tij.

Po ashtu, të ndalemi dhe të kujtojmë mëkatet, ato lënë shenja të këqija dhe të

rënda në zemrën e njeriut. Ato dëmtojnë çdo gjë që ka të bëjë me njeriun. Mëkati e shuan dritën e diturisë në zemrën e njeriut e pengon edhe nga rizku (furnizimi). Mëkati e pengon njeriun nga kënaqësia e adhurimit dhe e mbush zemrën e tij me errësirë. Mëkati e bën njeriun të pavlerë përpara Allahut të Lartësuar.

“Atë që e poshtëron Allahu nuk ka kush që mund ta bëjë të ndershëm”. (el-Haxh, 18)

Të nderuar lexues!

Pas kësaj dëshiroj t'i kujtoj vetes së pari, por edhe juve, si mund të arrimë deri te të mirat, shpërblimet e Allahut të Lartësuar, me një fjalë si ta mbushim librin e llogarive me më tepër mirësi dhe sevape.

Format dhe mënyrat janë të shumta, por neve na mbetet që t'i hulumtojmë këto rrugë, me të vetmin qëllim: të arrimë deri te kënaqësia e Allahut të Lartësuar në këtë botë dhe në botën tjetër, te xhenetet e larta.

Në vazhdim do të kujtoj dhe shënoj vetëm disa prej këtyre formave të veprimt:

Dituria, mësimi dhe leximi i Kur'anit.

Muhamedi, salAllahu alejhi ve selem, ka thënë:

- *“Kush ecën rrugës për të kërkuar dituri (ilm), Allahu me këtë vepër ia lehtëson atij rrugën për në xhenet”.* (Transmeton Muslimi)

- *“Më i miri prej jush është ai që e mëson Kur'anin dhe ua mëson të tjerëve Kur'anin”.* (Transmeton Buhariu)

- *“Lexoni Kur'anin, se ai (Kur'ani) do t'ju vijë si ndërmjetësues për pronarët (lexuesit) e tij në Ditë të Kiametit”.* (Transmeton Muslimi)

Selami dhe dashuria për hir të Allahut të Lartësuar.

Muhamedi, salAllahu alejhi ve selem, ka thënë:

- *“Nuk do të hyni në xhenet deri sa nuk besoni, por nuk do të besoni deri sa nuk do të duheni mes vetit. A (dëshironi) t'ju tregoj një vepër, që po e bëtë, do të duheni mes vete: përhapeni (përdoreni) selamin mes vete”* (Transmeton Muslimi)

- *“Allahu do të thotë në Ditë të Kiametit: ku janë ata që janë dashur për hirin Tim, që sot do t'i fus (shpërblej) nën hijen Time, në këtë ditë që s'ka hije tjetër përveç hijes Sime”* (Transmeton Muslimi)

Mirësjellja dhe kujdesi për familjen.

Muhamedi, salAllahu alejhi ue selem, është pyetur:

- Çka i shtyn më së shumti njerëzit në xhenet? U përgjigj duke thënë: *“Devotshmëria (takvallëki) dhe sjellja e mirë”* (Transmeton Tirmidhiu)

- Ndërsa për kujdesin familjar ka thënë: *“Farefisnia është e varur për Arshin dhe thotë: kush kujdeset për mua, Allahu e lidh për rahmetin e Tij dhe kush nuk kujdeset për mua, Allahu e këput (largon) nga mëshira e Tij”* (Transmeton Buhariu)

Bamirësia ndaj prindërve si dhe kujdesi ndaj jetimëve.

Muhamedi, salAllahu alejhi ue selem, ka thënë:

- *“Vaj për të, vaj për të dhe vaj për të, i thanë: për kë o i Dërguar i Allahut? Tha: Kush i arrin prindërit e tij në pleqëri ose njërin prej tyre dhe nuk hyn në xhenet”.* (Transmeton Muslimi)

- *“Unë dhe kujdestari i një jetimit do të jemi në xhenet kështu, dhe tregoi me gishtin tregues dhe të mesëm”.* (Transmeton Buhariu)

Falja e namazeve ditore.

Muhamedi, salAllahu alejhi ue selem, ka thënë:

- "Secilit musliman, kur i vjen koha e namazit, merr mirë abdesin pastaj e fal me frikë-respekt dhe rukunë e bënë mirë, do t'i fshihen mëkatet që i ka bërë më parë, nëse nuk ka bërë mëkatet të mëdha. Kjo i vazhdon gjatë gjithë jetës së tij". (Transmeton Muslimi)

Agjërimi që është detyrim dhe ai vullnetar

Muhamedi, salAllahu alejhi ue selem, ka thënë:

- "Kush e agjëron Ramazanin me besimin dhe shpresën e shpërblimit, do t'i falen mëkatet që i ka bërë më parë". (Transmeton Buhariu)

- "Secili musliman që agjëron një ditë në rrugë të Allahut, për këtë ditë Allahu ia largon fytyrën nga zjarri i xhehenemit shtatëdhjetë vjet". (Transmeton Buhariu)

- "Agjërimi nga tre ditë prej çdo muaj është sikur të agjërosh tërë vitin". (Transmeton Buhariu)

- "Kush e agjëron Ramazanin dhe e pason me agjërim të gjashtë ditëve të Shevvalit, do të ketë shpërblim si të kishte agjëruar tërë vitin". (Transmeton Muslimi)

Respektimi i të vdekurit duke ia falur namazin e xhenazes.

Muhamedi, salAllahu alejhi ue selem, ka thënë:

- "Kush dëshmon një xhenaze deri sa t'i falet namazi, ka shpërblim një kiratë, kurse kush e dëshmon një xhenaze deri sa të varroset, ka shpërblim dy kirata. i thanë: çka

janë këto kirata? Tha: janë sa dy kodra të mëdha". (Transmeton Buhariu)

Përcjellja e salavateve mbi Muhamedin, salallahu alejhi ue selem.

Muhamedi salallahu alejhi ue selem, ka thënë:

- "Kush dërgon një salavat mbi mua, Allahu i dërgon dhjetë salavatë mbi të". (Transmeton Muslimi)

Të nderuar lexues!

Këto janë vetëm disa forma për të arritur deri të falja dhe mëshira e Allahut të Lartësuar. Besimtari kureshtar duhet të tregojë vullnetin dhe gatishmërinë për t'i kërkuar, për t'i hulumtuar rrugët e duhura që të drejtojnë deri të kënaqësia e Allahut të Lartësuar.

Besimtarët kanë rastin dhe mundësinë për ta gjetur veten në llojlojshmërinë e adhurimeve, atyre u mbetet ta realizojnë shëtitjen prej një adhurimi në tjetrin.

E lus Allahun e Lartësuar me emrat e Tij të bukur dhe cilësitë e Tij të larta që ta pastrojë nijetin tim!

Allahu im! Më bëj të lumtur në këtë botë dhe në botën tjetër!

Allahu im! Më regjistro në rangun e të shpëtuarve në dynja dhe në ahiret!

Allahu im! Ma zbardh fytyrën në atë ditë kur zbardhen fytyrat e miqve të Tu!

Allahu im! Pranoja veprat besimtarëve dhe besimtarëve!

Allahu im! Më fal mua, prindërit e mi dhe të gjithë besimtarët!

Dëshiroj t'i kujtoj vetes së pari, por edhe juve, si mund të arrimë deri te të mirat, shpërblimet e Allahut të Lartësuar, me një fjalë si ta mbushim librin e llogarive me më tepër mirësi dhe sevape.

Hipnoza nga këndvështrimi Islam - ndërmjet lejimit dhe ndalimit



Shkruan: Alaudin ABAZI

Të flasësh për hipnozën dhe se çfarë dispozite mban Islami ndaj kësaj problematike, duhet qasje e shumanshme dhe njohuri të hollësishme, si në lëmi të ndryshme të fesë, ashtu edhe njohuri të përpikta në lëmin e psikologjisë (ose së paku të dhëna të sakta

dhe të qarta); prandaj edhe është vështirë të jepet ndonjë përkufizim i qartë dhe i prerë në këtë, nëse është e lejuar ose jo.

Ajo që e koklavit çështjen edhe më shumë, është edhe fakti se ka shumë paqartësi dhe mjegullina rreth hipnozës

Artikuj

dhe metodave të cilat aplikohen, prandaj edhe disa studiues e trajtojnë këtë si “pseudoshkencë”, apo flasin për hipnozën duke e radhitur atë si problematikë të “parapsikologjisë”, e cila shpesh bie ndesh me gjykimin se mund të vështrohet si shkencë².

Ky është edhe shkak, siç do të shohim edhe në vijim, përse disa dijetarë Islamë

janë më të prerë për sa i përket ndalimit të saj, duke u ndalur kryesisht edhe në faktin se hipnoza është edhe metodë manipulimi i magjistarëve në realizimin e pikave në shfaqjet e tyre dhe e fallxhinjeve për të arritur përfitime materiale.

Prandaj, duke i pasur parasysh këto që u thanë, ne do të mundohemi t'i pasqyrojmë disa njohuri të përgjithshme rreth hipnozës dhe metodave që kanë të bëjnë me të, më pastaj do të mundohemi t'i qasemi asaj nga këndvështrimi i Islam, duke përcjellë mendimet e dijetarëve Islam bashkëkohor që kanë folur në lidhje me të.

1. Njohuri të përgjithshme rreth hipnozës

a) Përkufizimi i Hipnozës:

Fjala hipnozë (hypnos) rrjedh nga greqishtja e vjetër dhe do të thotë “gjumë”. Shoqata e Mjekëve Britanikë e përkufizon hipnozën si **“Gjendje kaluese e kujdesit të zvogëluar të pacientit, gjendje në të cilën mund të shfaqen paraqitje të ndryshme personale ose të provokuara nga**

Hipnotizuesi duhet patjetër ta nxjerrë nga ajo gjendje personin e hipnotizuar dhe në qoftë se nuk ndodh kjo, atëherë ka mundësi të ndodhin përfundime fatale.

rrethi i jashtëm”. Kurse prof. Çarls Mater, i Universitetit të Majamit, thotë: **“Hipnoza është gjendje e ndryshueshme e vetëdijes, të cilën e karakterizon rritja e përqendrimit, rritja e relaksimit dhe rritja e sugjestionit”**. Me fjalë tjera hipnoza është gjendje e veçantë e vetëdijes, e nënshtresave të psikes

të vëna në lëvizje dhe e përqendrimit të vëmendjes, shpesh në mënyrë të paarsyeshme, të barazuar me ëndrrën. Personi i hipnotizuar bie nën ndikimin e sugjestionëve të hipnotizuesit, vetëdija e tij ndryshon, sepse bëhet plotësisht e kufizuar në atë çfarë hipnotizuesi flet dhe sugjeron; të gjitha përmbajtjet e tjera shqisore dhe të gjitha mendimet janë të eliminuara.

b) Hipnoza dhe gjumi:

Në kohët e mëhershme, hipnoza është konsideruar si një lloj gjumi³, pasi personi i hipnotizuar duket sikur gjendet në ndonjë ëndërr, por shumë studiues bashkëkohorë e mohojnë një gjë të tillë. Ata theksojnë se gjurmimet më të reja kanë treguar se ky krahasim me ëndrrën nuk është i drejtë. Matja e valëve trunore ka treguar se personi në hipnozë i ngjan më shumë njeriut në gjendje të zgjuar, të shtensionuar, sesa njeriut në ëndërr të vërtetë. Pos kësaj, vëmendja gjatë kohës së ëndërrimit humbet, kurse në hipnozë është veçanërisht e shprehur. Paskëtaj, në gjumin normal pacienti nuk merr për-

¹ Parapsikologjia klasifikohet si degë e psikologjisë, e cila merret me studimin e dukurive, që janë jashtë fuqisë së të kuptuarit të shqisave tona (paranormale), ku shpesh i kalojnë edhe ligjet ekzistuese të shkencës bashkëkohore.

² Shih p.sh. librat "Parapsikologjia" dhe "Hipnoza" nga Sabir Krasniqi.

³ Prandaj emërtimi i saj rrjedh nga fjala "hypnos", që do të thotë gjumë.

shtypjet e jashtme, ndërsa në gjumin hipnotik dëgjohen edhe pëshpërimat më të vogla. Për këtë, ata mohojnë që hipnoza të jetë gjumë dhe të quhet ashtu; ata thonë se hipnoza është një lloj transi (ekstaze, shkëputje nga bota konkrete), dhe shfaqet disa shkallë ose nivele.

c) Hipnoza dhe magjia (sihri):

Disa që flasin rreth hipnozës vërtetojnë që ajo të jetë lloj magjie (bashkëpunimit me xhin), madje, e njohur qysh në kohët e hershme. Ata thonë se ajo është e përafërt me ritet vudu (lloj magjie), kurse Budizmi e praktikon hipnozën për të arritur gjendjen e Nirvanës. Sido që të jetë, mund të thuhet se mënyra se si sillet personi i hipnotizuar dhe forma se si i pranon urdhrat nga hipnotizuesi (nuk gabojmë nëse themi edhe se si i nënshtrohet), jep të kuptohet se hipnoza dhe magjia kanë të përbashkët disa gjëra, apo së paku ngjasojnë mes njëra-tjetrës. Prandaj, disa nga dijetarët Islamë, të cilët kanë folur rreth hipnozës, kanë qenë shumë të prerë në ndalimin e saj dhe e kanë konsideruar lloj magjie.

d) Vetëdija dhe ndërvoja:

Ata që flasin rreth hipnozës thonë se njeriu, në jetën e përditshme e normale nuk shfrytëzon maksimumin e aftësive psikike dhe fuqive fizike që zotëron. Prandaj theksojnë se, personaliteti i secilit njeri mbart në vetvete një grumbull të fshehtash që bartësi (njeriu) nuk i kupton, as i njeh edhe vetë. Me anë të hipnozës arrihet të depërtohet në ndërvojen e njeriut. Hipnotizuesi arrin të vendosë në lëvizje këto mundësi të fshehta, duke e bërë pacientin (personin e hipnotizuar) të përballojë gjërat që nuk do t'i përballonte dot në rast se ndodhej në

gjendje normale, siç janë: dhembjet e mëdha, sëmundjet, traumat e ndryshme, peshën e lartë (është e mundur që mbi të të vendoset peshë jashtëzakonisht e madhe dhe ai mos ta ndiejë atë) dhe gjëra tjera.

e) Hipnoza dhe mjekësia:

Në fushat e ndryshme të mjekësisë, hipnoza është e njohur si metodë që mund të shfrytëzohet në mjekimin e disa vështirësive psikike (hipnoterapia), por edhe sëmundjeve organike. Me anë të hipnozës mund t'i sugjerohet pacientit se vështirësitë e tij do t'i pushojnë dhe ato të paktën për një kohë mund të ndërpriten. Hipnoza shfrytëzohet edhe në mjekimin e sëmundjeve të pastra organike, si mjekimin e tensionit të gjakut, disa sëmundje të tjera të zemrës dhe të enëve të gjakut, astma bronkiale, si dhe anestezi me rastin e ndërhyrjeve kirurgjikale. Po ashtu, është i njohur përdorimi i hipnozës në mjekimin e dhembjeve të kokës, në stomatologji, në mjekimin e alkoolistëve dhe të narkomanëve, në mjekimin e belbëzimit etj.

f) Hipnoza dhe rreziku:

Në shumë vende perëndimore hipnoza u lejohet vetëm mjekëve psikologë, sepse, nëse ndodh diçka ndryshe nga ajo që hipnotizuesi kishte menduar (aq më tepër te personat që ndikohen shpejt) mund të ketë pasoja të rënda psikopatologjike. Hipnotizuesi duhet patjetër ta nxjerrë nga ajo gjendje personin e hipnotizuar dhe në qoftë se nuk ndodh kjo, atëherë ka mundësi të ndodhin përfundime fatale. Një rast të tillë ka pasur hipnotizuesi shumë i njohur anglez Paulo Mecena pas një emisioni televiziv, ku një nga të hipnotizuarit vrau veten pas tre a

katër orësh që mbaroi emisioni.

Në Angli, të gjithë personat që dinë të hipnotizojnë kanë certifikatë të veçantë dhe, në qoftë se nuk e zotërojnë një të tillë dhe merren me hipnotizim, dënohen me ligj.

2. Hipnoza nga këndvështrimi Islam:

Gjërat të cilat u cekën më lart ishin informacion që plotëson njohuritë tona rreth hipnozës dhe metodave të saja, në vazhdim do të sjellim qëndrimet e dijetarëve rreth kësaj problematike.

Nëse përcjellim thëniet e dijetarëve Islamë rreth hipnozës, por edhe të studiuësve e hulumtuesve të cilët e kanë trajtuar këtë nga këndvështrimi islam, shohim se mendimet e tyre dallojnë varësisht se si i janë qasur çështjes, apo edhe në çfarë konteksti u janë drejtuar atyre pyetjet.

Kështu, e shohim se kur disave u është drejtuar pyetja rreth hipnozës, duke e ngjasuar atë me magjinë (bashkëpunimin me xhin) ose duke treguar format e keqpërdorimit të cilat ndodhin, përgjigja ishte se ajo është e ndaluar, madje është llogaritur edhe shirk.

Në anën tjetër, disa të tjerë që kanë pasur pikënisje trajtimin e hipnozës si metodë e njohur në mjekësi, janë më liberalë, pasi që shihet se ata i kanë bërë qasje tjetër kësaj problematike.

Në vazhdim do të përcjellim disa fetva, të cilat kanë pasur pikënisjet e lartpërmendura kur janë dhënë:

Fetvaja e komisionit të përhershëm për fetva

Komisioni i përhershëm për fetva i Arabisë Saudite⁴ në fetvanë numër 1779 i përgjigjet një letre që është dërguar nga

⁴ Komisioni i përhershëm për fetva i Arabisë Saudite (El-Ixhne Daime) është organi më i lartë shkencor për studime dhe fetva në Arabinë Saudite.

një person. Pyetësi i bën tri pyetje të përbashkëta; pyetja e parë ka të bëjë rreth magjisë dhe bashkëpunimit me xhin. Pyetja e dytë rreth hipnozës dhe e treta rreth një thënieje, a është lloj shirku, apo jo.

Pyetësi i shtron këto pyetje:

Çfarë është qëndrimi i Islamit rreth kërkimit të ndihmës nga xhinët për të arritur në njohtjen e fshehtësive sikurse magjia dhe falli?

Çfarë është dispozita e Islamit rreth Hipnozës me anë të së cilës arrin mundësinë personi i cili e bënë këtë t'i flasë atij në gjumë. Në këtë formë arrin ta mbizotërojë atë dhe ta urdhërojë në lënien e gjërave të shëmtuara (të ndaluara) ose të shërohet nga ndonjë sëmundje psikike ose edhe të kryejë ndonjë punë të cilën e kërkon personi i cili e hipnotizon atë?

A lejohet të themi në Islam "për hir të filanit", a është ky një lloj betimi, apo jo?

Nga frika e zgjerimit, ne do të sjellim vetëm përgjigjen e dytë, që ka të bëjë me temën tonë:

Përgjigje:

b) "Hipnoza është lloj i magjisë me të cilin përdoret xhini, i cili arrin ta detyrojë personin e hipnotizuar t'i nënshtrohet hipnotizuesit. Kështu, personi i hipnotizuar flet me gjuhën e xhinit dhe i jep atij fuqi në kryerjen e disa veprave që kërkon hipnotizuesi. Kjo ndodh pasi hipnotizuesi është një person që është i sinqertë me xhinin dhe ai për këto shërbime (që xhini t'ia realizojë) kryen disa vepra me të cilat i afrohet xhinit. Me këtë, xhini e bën personin që hipnotizohet t'i nënshtrohet dhe të bëjë vepra që i kërkojnë atij. Në këtë mënyrë shfrytëzohet hip-

noza dhe shndërrohet në taktikë ose mjet me të cilin arrihet të gjendet vendi i sendit të vjedhur, ose të humbur, ose shërimin e të sëmurit, ose në kryerjen e çfarëdo pune. Kjo është e ndaluar dhe llogaritet prej shirkut ashtu si u sqarua më lart, sepse nënkupton se kërkon mbështetjen e dikujt tjetër përveç Allahut dhe kjo është jashtë përcjelljes së shkaqeve dhe arsyeve (sebepeve) të zakonshme të cilat Allahu ua mundësoi dhe lejoi njerëzve t'i përcjellin.”

Nga kjo përgjigje shohim se hipnoza jepet e ndërlydhur në të gjitha aspektet si bashkëpunim me xhin.

Fetvaja e dijetarit të mirënjohur Abdullah Xhibrin, Allahu e ruajt, rreth hipnozës:

Me një rast është pyetur njëri nga dijetarët më të vjetër të kohës sonë, shejh Abdullah b. Xhibrin (Allahu e ruajt) rreth hipnozës dhe ai u përgjigj:

“Vërehet se hipnoza është formë e mpirjes që i bëhet njeriut, sikurse anestezia (në mjekësi), që mpin ndjenjat e njeriut. Nuk mbaj në mend ndonjë thënie të fukahave rreth saj. Por, pasi në disa raste mund të jetë e dobishme, qoftë në kryerjen e ndonjë operacioni ose diç të ngjashme, është e lejuar. Nga ana tjetër, nëse qëllimi i hipnozës është mpirja ose humbja e vetëdijes që të synohet me këtë dëmtimi i personit të hipnotizuar, si marrja e pasurisë ose diç e ngjashme, atëherë kjo është e ndaluar (haram).⁵”

⁵ Fetvat e shkruara me datën 24 Shaban, 1418 sipas hixhretit.

Vëmendja gjatë kohës së ëndërrimit humbet, kurse në hipnozë është veçanërisht e shprehur. Paskëtaj, në gjumin normal pacienti nuk merr përshtypjet e jashtme, ndërsa në gjumin hipnotik dëgjohen edhe pëshpërimat më të vogla

Mendimi i dr. Abdurrahman El-Xheri në lidhje me Hipnozën

Dr. Abdurrahman El-Xheri është ligjërues në Universitetin e Mbretit Halid në qytetin e Rijadit dhe në faqen elektronike www.islamtoday.net në rubrikën “Mjekësia dhe shëndeti” u përgjigjet pyetjeve të lexuesve të kësaj faqe. Ai, në këtë faqe u pyet rreth hipnozës kështu:

Pyetja: *Çfarë dispozite Islame ka hipnoza, e cila*

përdoret në mjekësi për shërim, duke qenë se mësimi rreth hipnozës është pjesë e plan-programit mësimor në fakultetet e mjekësisë? Kohë më parë, më ka rastisur të lexoj një fetva se është haram, për shkak se ka lidhje me xhinët. Gjithashtu, kam lexuar për këtë formë të shërimit shumë dhe nga ajo që kam parë ishte se kjo ka lidhje me aspektin psikik të njeriut dhe nuk ka të bëjë me magjinë dhe xhinët?

Përgjigja:

Rreth kësaj mund të përgjigjemi në disa pika:

1. (Pika e parë ka të bëjë me emërtimin e hipnozës në gjuhën arabe dhe se cili term është më adekuat të përdoret.)

2. Disa fetva që janë dhënë rreth hipnozës kanë pasur pikënisje aplikimin jo të drejtë të hipnozës dhe këto praktika nuk hyjnë në domethënie të hipnozës. Të informohemi rreth gjërave të fshehta (gajbin), përdorimi i xhinëve (nëpërmjet hipnozës) dhe magjia; këto gjëra i mohojnë ata mjekë dhe specialistë që e praktikojnë hipnozën si metodë shërimi.

3. *Hipnoza është një fushë shkencore e njohur, që luan rol në shërimin e sëmundjeve të përcaktuara. Ajo ka rregulla, baza dhe arrin suksese të njohura mjekësore.*

4. *Me hipnozë arrihet të bindet i sëmuri në përdorimin e shërimit, në rast se ky e refuzon në rrethana të rëndomta. Gjithashtu, me këtë arrihet që të i sëmuri të ngulisim një bindje të re pozitive për ta tejkaluar botëkuptimin negativ që kishte më parë.*

5. *Ekzistojnë disa praktika që janë përzierë me hipnozën që aplikojnë disa. Këto praktika, në vetvete përmbajnë gjëra të ndaluara (haramë). Prandaj, disa nga njerëzit kanë fituar bindjen se hipnoza është e ndaluar, por ndalimi i tyre ka qenë si rezultat i këtyre praktikave të hipnozës, sikurse aplikohet kjo nëpër cirqe ku ata përdorin magjinë dhe truke të ndryshme.*

6. *Hipnoza, e cila trajtohet si metodë shërimi, mund të aplikohet në të mirë dhe mund të përdoret në të keq. Bindja e tjetrit (të sëmurit) për një mendim ose çështje të caktuar (me anë të hipnozës), bazohet në gjykimin nëse ai mendim ose ajo çështje është e lejuar apo jo. Nëse mendimi ose çështja është e mirë, atëherë lejohet të përdoret në shërim, nëse është e kundërt, atëherë kjo nuk lejohet⁶*

Sqarim

Më lart theksuam se mendimet e dijetarëve dallojnë në këtë çështje varësisht nga forma se si e kanë trajtuar ata hipnozën dhe kjo u vërtetua edhe me sjelljen e disa fetvave. Pastaj, edhe vetë hipnoza, sikundërse u kuptua edhe më lart, shfaq në vetvete shumë paqartësi dhe mjegulli-

na, prandaj këto dallime, në konsiderimin e saj si të lejuar, respektivisht të ndaluar, duhet të kuptohet drejtë, pasi ata që e kanë ndaluar, i kanë dhënë prioritet dëmeve dhe praktikave që aplikojnë magjistarët dhe fallxhinjtë, të cilët arrijnë qëllimet e tyre me anë të hipnozës. Kurse ata që e kanë lejuar me disa kushtëzime, e kanë shikuar hipnozën si metodë mjekimi.

Përfundim

Në fund të kësaj teme themi se nga mendimet e dijetarëve dhe studiuesve që kanë folur në këtë fushë, disa nga të cilat u përmendën edhe më lartë, mund të konstatojmë se hipnoza mund të ndahet në dy lloje:

Hipnoza si metodë psikike mjekësore, me anë të së cilës depërtohet në ndërrijen e njeriut dhe arrihet të bindet i sëmuri në përdorimin e shërimit, që e refuzonte në rrethana të rëndomta të tij ose me këtë arrihet që tek i sëmuri të ngulisim një bindje të re pozitive për ta tejkaluar botëkuptimin negativ që kishte më parë. Gjithashtu hipnoza me këtë përkufizim mund të përdoret edhe në shërimin e disa sëmundjeve organike, apo përdorimin e saj si anestezi, ashtu si u sqarua edhe më lart.

Metodat që aplikojnë magjistarët dhe fallxhinjtë, të cilët bashkëpunojnë me xhinët dhe shejtanët, përmes të cilave i joshin njerëzit për të arritur përfitime materiale dhe dobi personale. Kjo nuk ka të bëjë me hipnozën e njohur në mjekësi, pasi nuk është dituri e bazuar në arsyen dhe logjikën e shëndoshë dhe për këto praktika të ndaluara ka të bëjë fetvaja e Komitetit të Përhershëm për Fetva.

⁶ Shih: www.islamtoday.net



PEŠË GJËRAT, që e shkatërrojnë zemrën

Ibn Kajjim EL-XHEVZIJE

Pesë gjërat, që e shkatërrojnë zemrën janë: 1. Ndejat e shumta me njerëz, 2. Shpresa, 3. Të lidhurit ngushtë me dikë tjetër, pos Allahut, 4. Të ngopurit nga ushqimi dhe 5. Gjumi.

Këto pesë gjëra janë prej gjërave më shkatërruese të zemrës.

1. Ndejat e shumta me njerëz

Pasojat që lë të ndenjurit e shumtë me njerëz, janë mbushja e zemrës me avullin e frymëmarrjeve të njerëzve, derisa ajo të nxihet. Kështu, ajo e obligon një person të tillë në ndonjë ndasi, përçarje, brengë, hall, dobësim si dhe

Artikuj

bartjen e ndonjë gjëje, që është i paaftë ta bartë prej lodhjes që ka nga shoqëria e keqe. Obligon, po ashtu, në humbjen e interesave të tij dhe nuk do të ketë kohë të merret me to, për shkak të angazhimit të tij me ta dhe me problemet e tyre. Kështu që ideali i tij do të ndahet në kërkesat dhe në dëshirat e tyre. Atëherë një njeri i tillë, çfarë i mbetet të veprojë për Allahun dhe botën e Ahiretit?!

Përveç kësaj, sa të ligë ka sjellë ndenja e shumtë me njerëz, dhe sa dhunti ka larguar? Sa sprova ka sjellë e sa të mira ka zhvlerësuar? Sa goditje ka sjellë dhe në sa sprova ka hedhur? A thua vallë, kush është epidemia e njerëzve përveç njerëzve?!

Ndjenjat, që bëhen në formë të dashurisë reciproke në këtë botë, dhe në formë të plotësimit të nevojave njëri me tjetrin, kur të dalin në shesh të vërtetat Ditën e Gjykimit, shndërrohen në armiçësi dhe, nga ndjenja e madhe për pendim, një personi i tillë do të kafshojë duart, ashtu siç paralajmëron Allahu i Madhërisëm: **“Atë ditë zulumqari do t’i kafshojë duart e veta dhe do të thotë: “I mjeri unë, ta kisha marrë rrugën e Pejgamberit!” O shkatërrimi im, ah të mos e kisha bërë filanin mik! Në të vërtetë, pasi e gjeta rrugën e drejtë, ai më largoi mua prej asaj, e djalli është ai që njeriun e humb dhe e lë të vetmuar.”** (El Furkan, 27,28 dhe 29)

Allahu po ashtu thotë: **“Atë ditë shokët e ngushtë do të jenë armiq të njëri-tjetrit, përveç atyre që ishin të**

Prej gjumit, që gjithashtu nuk bën dobi është gjumi në fillim të natës, menjëherë pas perëndimit të diellit (pas namazit të akshamit) e deri sa të largohet e zeza e natës së plotë (pas jacisë).

sinqertë në miqësi.” (Ez Zuhruf, 67)

Ibrahimi, alejhis selam, i tha popullit të vet: **“Ju përqaftuat, veç Allahut, idhuj vetëm sa për bashkëjetesë mes jush në jetën e kësaj bote, e në ditën e kiametit (ndryshon gjendja) ju do të refuzoni njëri-tjetrin dhe do të mallkoni njëri-tjetrin; fundi juaj është zjarri, për ju nuk do të ketë ndihmëtarë.”** (Ankebut, 25)

Kështu qëndron çështja me të gjithë ata që marrin pjesë me ty në një çështje apo interes. Kanë dashuri reciproke, përderisa ndihmojnë njëri-tjetrin në realizimin e atij interesi. Me të përfunduar procesi i atij interesi, vjen pendimi, dëshpërimi, dhembja etj., dhe dashuria e mëhershme shndërrohet në urrejtje, mallkim, dhe përçmim ndaj njëri-tjetrit.

Kriteri i dobishëm në çështjen e ndenjave është të rrih me njerëz në raste mirësie si në namazin e xhumasë, namazet me xhemaatë, nëpër bajrame, në Haxhillëk, në tubimet e kërimit të diturisë, në xhihad, në këshillime etj. Dhe duhet të distancohesh nga njerëzit në çështje të këqija si dhe kureshtje të panevojshme.

Nëse e kërkon nevoja që patjetër të përzihesh me njerëz në çështje të pandershme dhe nuk ke fare mundësi që të distancohesh, të kesh shumë kujdes e të mos pajtohesh me ta dhe të kesh durim për mundimin që ta bëjnë, sepse ata patjetër do të mundojnë, pasi ti nuk ke fuqi dhe nuk je ndihmës. Mirëpo ky mundim do të sjellë pas vetes krenari dhe dashuri

për ty. Do të madhërojnë dhe do të kesh lëvdata prej tyre, prej besimtarëve dhe prej Zotit të botëve. Në të kundërt, pëlqimi yt me ta do të sjellë përlulje dhe urrejtje për ty. Do t'i humbasë vlerat tua dhe do të kesh përcmim prej tyre, prej besimtarëve dhe prej Zotit të botëve. Pra, durimi në mundimet e tyre është më i mirë, ka të ardhme më të mirë dhe pasuri më të vlefshme.

Ndërsa, nëse e kërkon nevoja që të rrih me njerëz për çështje asnjëse e të lira, orvatu me zell, që tubimin ta shndërrosh, nëse ke mundësi, në tubim ku respektohet Allahu.

2. Shkatërruesi i dytë, udhëtimi nëpër detin e shpresës

Deti i shpresës është një det pa bregdet. Det, në të cilin udhëtojnë njerëzit e dështuar. Siç thuhet, “*shpresa padyshim është kapitali i të falimentuarve*”.

Valët e shpresave të rrejshme dhe iluzioneve të kota, luajnë vazhdimisht me lundruesin e tyre, ashtu siç luan qeni me cofëtinën. Shpresa është malli i çdo shpirti të ligë dhe të ulët, i cili nuk ka **vendosje të saktë** që me te t'i arrijë realitetet e jashtme. Përkundrazi, e ka zëvendësuar atë vendosje me shpresa iluzionit, dhe secili sipas gjendjes, të cilën e shpreson. Dikush shpreson forcën dhe pushtetin, dikush shpreson të shëtisë dhe të bëjë turizëm nëpër vende të ndryshme, dikush shpreson pasuri dhe gjëra të vlefshme, dikush tjetër shpreson në femra etj.

Sa më afër mëngjesit apo mbrëmjes të bëhet gjumi, pakësohet dobia e tij dhe shtohet dëmi e sidomos gjumi në kohën e ikindisë dhe në fillim të ditës, përveç ai që nuk ka fjet natën.

Dhe kështu, shpresuesi krijon një pamje që e kërkon në veten e tij, dhe arrin ta realizojë atë duke ndier kënaqësi me fitimin e saj. Përderisa ai është në këtë gjendje, kur të gdhihet nga gjumi i mashtrimit, i gjen duart e tij të “mbushura” me kashtë (kot).

Ndërsa, ai që ka vendosmërinë të lartë, shpresat e tij qëndrojnë rreth diturisë, besimit dhe veprës që të afron te Allahu. Shpresat e këtij të fundit janë besim, dritë dhe urtësi, kurse shpresat e atyre të tjerëve janë tradhti dhe mashtrim.

Pejgamberi, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, i ka lavdëruar shpresuesit e gjërave të mira, e në disa raste e ka krahasuar shpërblimin e tyre me shpërblimin e praktikuesve të atyre shpresave.

3. Shkatërruesi i tretë, të lidhurit ngushtë me dikë tjetër, pos Allahut

Ky është absolutisht shkatërruesi më i madh i zemrës. Nuk ka për zemrën diç më i dëmshëm se ky dhe asgjë nuk e shkëput nga interesat dhe kënaqësia më shumë se ky shkatërrues. Kur njeriu lidhet ngushtë me dikë tjetër pos Allahut, Allahu e dorëzon atë njeri tek ai, me të cilin është lidhur dhe ia nënshtron atij. Në këtë mënyrë, një njeri i tillë, me lidhjen e tij dhe me përqendrimin e tij me dikë tjetër pos Allahut, e ka humbur arritjen e synimit të tij prej Allahut. I tilli as fatin e tij prej Allahut e as shpresën e tij prej atij me të cilin është lidhur, nuk i ka arritur.

Allahu ka thënë: *“Dhe ata në vend të Allahut adhuruan zota të tjerë për t’u krenuar me ta. Përkundrazi, ata (idhujt) do të tërhiqen prej adhurimit të atyre dhe do të bëhen armiq të tyre.”* (Merjem, 81 dhe 82) Allahu po ashtu thotë: *“Po, shkojnë e në vend të Allahut adhurojnë zota të tjerë me shpresë se do të ndihmohen prej tyre. Ata nuk mund t’u ndihmojnë atyre, por këta (idhujtarët) u janë bërë ushtri e gatshme e tyre.”* (Jasinë, 74 dhe 75)

Ai që lidhet me dikë tjetër pos Allahut, i ngjason shembullit të atij që mbrohet nga vapa apo acari nën hijen e shtëpisë së merimangës, e cila është shtëpia më e dobët.

Pra, njerëzit më të poshtëruar janë ata që lidhen me dikë tjetër pos Allahut.

Ajo që humb një njeri i tillë prej interesave, lumturisë dhe shpëtimit të tij është më shumë sesa ajo që e ka arritur prej atij, që është lidhur me te. Ajo që ka arritur bile, është e pambrojtur nga zhdukja dhe shkatërrimi. Ai që lidhet me dikë tjetër pos Allahut, i ngjason shembullit të atij që mbrohet nga vapa apo acari nën hijen e shtëpisë së merimangës, e cila është shtëpia më e dobët.

Në përgjithësi, duhet ditur se baza e shirkut (rivalitetit të Allahut) dhe themeli mbi të cilin ngrihet, është të lidhurit me dikë tjetër pos Allahut. Qortimi dhe poshtërimi, i takojnë pastaj personit të tillë, siç thotë Allahu: *“E mos shoqëro me Allahun ndonjë zot tjetër, e të bëhesh i qortuar i pa përkrahur.”* (El Israë, 22) i qortuar, pra, d.m.th., të mos ketë kush që të lavdërojë, ndërsa i pa përkrahur, d.m.th., të mos ketë ndihmës për ty.

Dikush nga njerëzit mund të jetë i pa

përkrahur, por i lavdëruar, si p.sh. ai që është shtypur padrejtësisht. Dikush mund të jetë i qortuar, por i ndihmuar, si p.sh. ai që mbi-zotërohet mizorisht. Dikush pra, mund të jetë edhe i lavdëruar, po edhe i ndihmuar, si ai që ka arritur dhe zotëron vlera në mënyrë të ligjshme. Ndërsa, shirkbërësi, që lid-

het me dikë tjetër pos Allahut, është në grupin e katërt, i cili është më i ulët nga këta grupe, pra, as i lavdëruar e as i ndihmuar.

4. Shkatërruesi i katërt prej shkatërruesve të zemrës, ushqimi

Ky shkatërrues është dy llojesh:

1. Ushqim që shkatërron vetveti, siç janë gjërat e ndaluara haram. Të tillat po ashtu janë dy lloje:

a) të ndaluarat për të drejtën e Allahut siç janë; cofëtina, gjaku, mishi i derrit, mishi i shtazëve dhëmbëmprehta etj. Dhe

b) të ndaluarat për të drejtat e njerëzve, si p.sh. ushqimi i vjedhur, i uzurpuar, i plaçkitur, i marrë pa dëshirën e pronarit etj.

2. Ushqim¹ që shkatërron kur konsumohet me masë të tepruar, të ngopurit e tepërt etj. Ky ushqim i tepërt e pasivizon konsumuesin nga adhurimet dhe e angazhon në praktikën e konservimit të ushqimit në stomak derisa të “triumfojë”. Kur të triumfojë, do të angazhohet me shërimin e lëvizjes së asaj rezerve, me të mbrojturit nga dëmi i saj dhe me mundimin nga pesha e saj.

¹ Që në esencë është i lejuar hallall.

Kjo gjë do t'ia forcojë materiet e pasioneve dhe rrugët e qarkullimit të shejtanit dhe do t'i zgjerojë ato, sepse shejtani qarkullon në njeriun nëpër kapilarët e gjakut. Agjërimi ia ngushton rrugët shejtanit, e edhe ia mbyll, kurse të ngopurit ia shtron rrugët dhe ia zgjeron. Ai që ha shumë, ai edhe pi shumë. Ai që pi shumë pastaj edhe fle shumë. Një njeri i tillë humb edhe më tej shumë. Në hadithin e njohur i Dërguari, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, ka thënë: *"Njeriu nuk mbush ndonjë enë më keq se që e mbush barkun e tij. Do t'i mjaftonin njeriut disa kafshata që ta mbajë kurrizin (trupin) e tij. E nëse duhet që patjetër të hajë më shumë, atëherë 1/3 le të jetë për ushqim, 1/3 për pije dhe 1/3 për frymëmarrjen e tij."*

5. Shkatërruesi i pestë, gjumi i tepërt

Gjumi i tepërt e vdes zemrën, e rëndon trupin, e humb kohën dhe sjell pakujdesi dhe përtaci të shumta. Ka gjumë që është shumë i urryer dhe ka që është i dëmshëm pa kurrfarë dobie. Gjumi më i dobishëm është kur nevoja për të është e madhe. Gjumi i fillimit të natës është më i lavdëruar dhe më i dobishëm se ai i fundit të saj. Gjumi i mesit të ditës është më i dobishëm se ai i dy skajeve të saj. Sa më afër mëngjesit apo mbrëmjes të bëhet gjumi, pakësohet dobia e tij dhe shtohet dëmi e sidomos gjumi në kohën e ikindisë dhe në fillim të ditës, përveç ai që nuk ka fjet natën.

Kriteri i dobishëm në çështjen e ndejave është të rrih me njerëz në raste mirësie si në namazin e xhumasë, namazet me xhematë, nëpër bajrame, në Haxhillëk, në tubimet e kërkimit të diturisë, në xhihad, në këshillime etj.

Urrehet gjumi në mes të namazit të sabahut dhe lindjes së diellit, sepse ajo është kohë e fitimeve. Sipas vlerësuesve të mirëfilltë të adhurimit, të bëhet adhurim në këtë kohë ka vlerë të madhe edhe ata që tërë natën e kanë kaluar me adhurim, nuk do t'i lejonin vetes të ulen deri sa të lindë dielli. Për shkak se kjo kohë është fillimi i ditës dhe çelësi i saj. Është koha e zbritjes së rrizkut, arritjes së hises sate si dhe ardhja e begatisë. Aty ndërtohet dita dhe me gjykimin e asaj pjese do të gjykohet e tërë dita. Andaj gjumi në atë kohë duhet të jetë si gjumi i të detyruarit.

Në përgjithësi, gjumi më i drejtë dhe më i dobishëm është gjumi i gjysmës së parë të natës dhe pjesa 1/6 e fundit prej natës. Ky është gjumi më i drejtë sipas mjekëve. Çka shtohet mbi këtë masë apo mungohet, shkakton sipas tyre në natyrë devijime, varësisht sipas ndryshimeve të bëra.

Prej gjumit, që gjithash-tu nuk bën dobi është gjumi në fillim të natës, menjëherë pas perëndimit të diellit (pas namazit të akshamit) e deri sa të largohet e zeza e natës së plotë (pas jaciesë). Pejgamberi, lavdërimi dhe shpëtimi i Allahut qofshin mbi të, e ka rrejtur gjumin në këtë kohë. Pra ky gjumë është i urryer nga aspekti i sheriatit dhe ai i natyrës. Prej Allahut kërkohet ndihmë!

**Përktheu dhe përshtati:
Muhammed Dërmaku**

² Trans. Ahmedi, Termidhiu dhe Hakimi. Albani e trajton për hadith sahih.



Objektivat e Sheriatit (2/2)

Shkruan: Talha KURTISHI

2. RUAJTJA E JETËS:

Shenjtëria e jetës është një prej domosdoshmërive të ekzistencës njerëzore. Sheriati ka vendosur një numër ligjesh që e sigurojnë shenjtërinë e jetës:

a) Ruajtja e jetës nga aspekti ekzistencial:

- Ligjësimi i martesës si mjet për ripërtëritjen e llojit njerëzor, për

shtimin e popullatës njerëzore që do ta banojë dhe zhvillojë jetën në tokë si parakusht për generatat e ardhshme. Allahu, subhanehu ve teala, thotë: *“Dhe nga faktet (e madhështisë së) e Tij është që për të mirën tuaj, Ai krijoi nga vetë lloji juaj palën (gratë), ashtu që të gjeni prehje tek ato dhe në mes jush krijoi dashuri dhe mëshirë. Në këtë ka argumente për njerëzit që mendojnë.”* (Er Rum, 21)

b) Mjetet për sigurimin e vazhdimësisë së jetës:

- Islami e obligon njeriun të sigurojë kushtet e vazhdimësisë së jetës. Këtu bëjnë pjesë: ushqimi, veshmbathja dhe strehimi. Është e ndaluar që myslimani t'u shmanget këtyre domosdoshmërive deri në shkallë kur një veprim i tillë rrezikon jetën e tij. Sheriati e detyron shtetin që këto domosdoshmëri

esenciale t'ia sigurojë njeriut që nuk ka mundësi që ato t'i sigurojë vetë.

- Shteti është i obliguar të sigurojë infrastrukturën e nevojshme që garanton sigurinë publike. Sistemi i drejtësisë dhe forcat e zbatimit të ligjit – policia.

- Mbrojtja e nderit njerëzor është obligim. Ky obligim realizohet nëpërmjet dispozitave që e ndalojnë akuzën e pa bazë, shpifjen dhe fyerjen. Me ligj sanksionohen aktivitetet njerëzore të paarsyeshme.

- Sheriati parasheh disa koncesione në kushte të caktuara për të mënjanuar vështirësitë që mund të shkaktojnë dëm personal dhe lëndim. Shembuj janë lejimi i mos agjërit në Ramazan për udhëtarin dhe atë që është i sëmurë, ligjësimi i shkurtimit të namazit gjatë udhëtimit etj.

- Islami e ka ndaluar marrjen e jetës në çdo lloj forme (vetëvrasje dhe vrasje). Për vetëvrasjen Allahu, subhanehu ve tealë, thotë:

“...dhe mos mbytni veten tuaj. Vërtet, Allahu është i mëshirueshëm për ju.” (En Nisa, 29)

“Për këtë (shkak të atij krimi) Ne

Shteti Islam është i obliguar që të gjithëve t'u ofrojë mundësi për mësim si një e drejtë e përgjithshme. Kërkimin e dijeve e ka bërë obligim për çdo mysliman dhe myslimane.

u shpallëm (ligj) beni israilëve se kush mbytn një njeri (pa të drejtë), pa pasë mbytur ai ndonjë tjetër dhe pa pasë bërë ai ndonjë shkatërrim në tokë, atëherë (krimi i tij) është si t'i kishte mbytur gjithë njerëzit. E kush e ngjall (bëhet shkak që të jetë ai gjallë) është si t'i kishte ngjallur (shpëtuar) të gjithë njerëzit...” (El Maide, 32)

“...mos e mbytni njeriun sepse mbytnjen e tij e ndaloj Allahu, përpos kur është me vend. Këto janë porositë e Tij, kështu që të mendoni thellë.” (El En'am, 151)

“Kush e mbytn një besimtarë me qëllim, dënimi i tij është xhehenmi, në të cilin do të jetë përgjithmonë. Allahu është i hidhëruar ndaj tij, e ka mallkuar dhe i ka përgaditur dënim të madh.” (En Nisa, 93)

Ligjësimi i Kisasit për vrasjen me qëllim, dijen dhe kefaretin për vrasje gabimisht:

“O ju që besuat, u është bërë obligim gjurmimi (kisasi) për dënim për mbytnje...” (El Bekare, 178)

“Asnjë besimtari nuk i është i lejuar të mbysë besimtarin tjetër, përpos gabimisht. E kush e mbytn gabimisht një besimtarë, ai është i obliguar ta lirojë një rob besimtarë dhe shpagimin (e gjakut) t'ia dorëzojë familjes së tij, përpos në qoftë se ia falin (familja gjakun). Në qoftë se ai (i mbytni gabimisht) është besimtarë, por i takon popullit që është armik i juaji, atëherë është obligim vetëm lirimi i një robi bes-

imtar. Në qoftëse se ai (i mbyturi) është nga ai popull që keni marrëshjen me të, atëherë është obligim shpagimi i (gjakut) që i dorëzohet familjes së tij dhe lirimi i një robi besimtar. E kush nuk ka mundësi (të lirojë një rob), le të agjëroj dy muaj rresht, si pendim (i pranuar) ndaj Allahut. Allahu është më i dijshti, ligdhënësi më i drejtë.” (En Nisa, 92)

- Xhihadi është shpallur për të mbrojtur jetën dhe për t'u ndihmuar të dobëtëve:

“Ç’keni që nuk luftoni për Zotin dhe për (t’i shpëtuar) të paafittit: burrat, gratë e fëmijët, të cilët lutën: “Zoti ynë! Nxirrna nga ky fshat (Meka), banorët e të cilit janë mizorë. Jepna nga ana Jote shpëtim e ndihmë!” (En Nisa, 75)

- Atëherë kur ka mundësi, myslimani është i detyruar të shpëtojë jetën e atij që rrezikohet me vrasje të padrejtë.

- Sheriati parashihet vetëmbrojtjen për njeriun që sulmohet dhe e liron nga përgjegjësia për pasojat e kësaj vetëmbrojtjeje. Ky lirim nga përgjegjësia vlen në raste kur qëllimi për sulm ka qenë i dukshëm.

3. RUAJTJA E ARSYES – MENDJES

Islami i jep rëndësi të madhe arsyes, e cila është baza e përgjegjësisë për njeriun. Arsyja është atributi që e veçon dhe e ngre njeriun mbi krijesat tjera. Arsyja është kusht për kryerjen e obligimit të mëkëmbësit në tokë, post

ky me të cilin Allahu e ka obliguar njeriun. Duke pasur parasysh këtë rëndësi, Sheriati vendos një numër të madh rregullash për të siguruar shëndetin dhe lirinë e aftësive racionale.

- Islami e ka ndaluar përdorimin e çdo substance që ndikon në arsye, që e dëmton atë ose ul aftësitë e saj (alkooli dhe drogat).

- Islami ka vendosur dënime të ashpra legale për të dekurajuar përdorimin e lëndëve narkotike.

- E nxit rezonimin e shëndoshë, të pavarur në hulumtim dhe vërejtje, duke e refuzuar *teklidin* që nuk mbështetet në prova

“Ai që e fillon krijimin (e njeriut) e pastaj e përsërit atë (e ringjall pas vdekjes) dhe Ai që ju furnizon nga qielli e toka. A mos ka zot tjetër pos Allahut? Thuaj: “Sillni argumentet tuaja, nëse jeni të sinkertë!” (En Neml, 64)

Islami thërret në zhvillim dhe kultivim të mendjes në nivel material duke kërkuar ushqim të shëndoshë për forcimin e trupit dhe gjallërimin e mendjes. Për këtë shkak, nuk preferohet që gjykatësi të gjykojë atëherë kur është i uritur. Në nivelin intelektual, Islami nxit në kërkim të dijeve, të cilat i konsideron baza të besimit.

“Po Allahut ia kanë frikën nga robërit e Tij vetëm dijetarët, Allahu është mbi gjithçka, është mëkëmbës.” (El Fatir, 28)

Shteti Islam është i obliguar që të gjithëve t'u ofrojë mundësi për mësim si një e drejtë e përgjithshme. Kërkimin

Shteti është i obliguar të sigurojë infrastrukturën e nevojshme që garanton sigurinë publike. Sistemi i drejtësisë dhe forcat e zbatimit të ligjit - policia



e dijeve e ka bërë obligim për çdo mysliman dhe myslimane.

Islami e ngre lart pozitën e mendjes dhe statusin e të mençurve. Allahu, subhanehu ve teala, thotë:

“Të cilët i dëgjojnë fjalët dhe pasojnë atë më të mirën prej tyre. Të tillët janë ata që Allahu i udhëzoi në rrugën e drejtë dhe të tillët janë ata të mençurit.” (Ez Zumer, 18)

“Thuaj: “A janë të barabartë ata që dinë dhe ata që nuk dinë?” Po, vetëm të zotët e mendjes marrin mësim.” (Ez Zumer, 9)

- Aftësitë racionale duhet të mbrohen nga ndikimi i paragjykimeve, besëtytnive si dhe nga prangat e iluzioneve.

“Ata që duke mos pasur kurrfarë fakti pranë vetes, polemizojnë rreth argumenteve të Allahut. Kjo (polemikë) shton urrejtje të madhe te Allahu dhe te ata që kanë besuar. Po kështu Allahu vulos çdo zemër të arrogantit, të zullumqarit.” (Gafir, 35)

- Përdorimi i arsyes duhet të jetë i

frytshëm dhe i dobishëm, të kontribuojë në njohjen e të vërtetës. Këto do të arrihen me anë të këtyre dy qasjeve:

a) Vendosja e metodologjisë së shëndoshë për hulumtim racional, konfirmimi i gjërave para besimit në to.

“Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njohuri, pse të dëgjuarit, të pamurit dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi.” (El Isra, 36)

“Këta, populli ynë ka besuar zota të tjerë pos Atij, pse pra nuk sjellin ndonjë argument të qartë për ata? A ka më mizor se ai që shpif gënjeshtër ndaj Allahut?” (El Kehf, 15)

b) Thirrja në vështrim, lexim dhe meditim që mundëson zbulimin, saktësinë dhe harmoninë e ligjeve në Gjithësi. (Ixhtihadi, zbulimi i urtësive të Sheriatit, zbulimi i objektivave madhore dhe kështu me radhë) .

4. RUAJTJA E GJENEALOGJISË:

Më këtë nënkuptojmë mjetin për të ruajtur vazhdimësinë e llojit njerëzor

me anë të brezave trashëguese. Për të realizuar këtë objektivë, Islami i ka vendosur këto parime dhe dispozita:

1. Ligjësimi i martesës dhe ndalimi i marrëdhënieve joligjore.

2. Kujdes të veçantë për edukimin e fëmijëve dhe forcimin e lidhjeve

3. Ndërtimi i familjes mbi baza të shëndosha, sepse familja është kështjella ku strehohen dhe edukohen gjeneratat e ardhshme.

4. Rregullimi i marrëdhënieve mashkull-femër sipas një tërësie rregullash dhe kodesh morale. Këto rregulla kanë qëllime fisnike dhe parandalojnë praktikat destruktive në kontaktet mes gjinive.

5. Islami ndalon çdo lloj shkeljeje mbi namusin dhe nderin e huaj (ndalimi i zinasë dhe shpifjes).

“Laviren dhe lavirin t’i rrahni, secilin prej tyre me nga njëqind të rëna, dhe në zbatimin e dispozitave të Allahut mos u tregoni zemërbutë ndaj atyre dyve, nëse jeni që besoni Allahut dhe botës tjetër. E gjatë zbatimit të ndëshkimit ndaj tyre, le të jenë të pranishëm një numër besimtarësh.” (En Nur, 2)

“Edhe ata të cilët bëjnë shpifje për gratë e ndershme dhe nuk sjellin katër dëshmitarë, t’i rrahni ata me nga tetëdhjetë të rëna dhe atyre mos ua pranoni dëshminë më kurrë. Të tillët janë të pabesueshëm.” (En Nur, 4)

5. RUAJTJA E PASURISË

Islami nuk i mohon instinktët themelore, duke i kufizuar në suazat e asaj që është e pastër, e shëndosh,

mesatare. Një instinkt i tillë është edhe instinkti për pasurinë. Islami e lejon pronën individuale dhe e parandalon cenimin e kësaj të drejte me anë të legjislacionit përkatës. i tillë është sistemi i zekatit, trashëgimisë dhe sigurisë sociale. Nga kjo perspektive, islami e konsideron pasurinë nevojë e domosdoshme e jetës njerëzore.

a) Hapat që sigurojnë prodhimin dhe përvetësimin e pasurisë.

- Islami nxit në kërkim aktiv të rrizkut dhe furnizimit

- Angazhimi për të fituar lavdërohet (*Ushqimi më i mirë që ha njeriu është ai që ka fituar me duart e tij - hadith*)

- Lejimi i transaksioneve të drejta, që nuk përmbajnë elemente të padrejtësisë dhe cenimit të pronës së huaj

b) Ruajtja e vazhdimësisë së pasurisë:
- Pasuria përdoret në kufijtë e asaj që konsiderohet dobi e përgjithshme, ndalohet kamata që cenon baraspeshën shoqërore.

- Ndalohet shpenzimi i pasurisë për gjëra të ndaluara dhe njeriu nxitet të shpenzojë në rrugët e hairit.

- Ndalohet dhunimi i pronës së huaj me vjedhje, hile, mashtrim dhe uzurpim.

- Dispozita të veçanta për pasurinë e të miturve, jetimëve dhe personave me defekte mentale.

- Respektimi i kontratave të nënshkruara pa presion dhe elemente dhune

- Islami thërret në zhvillimin dhe shumimin e pasurisë duke përhapur efektin pozitiv të asaj pasurie që nuk duhet koncentruar në një rreth të ngushtë.

Bajrami,

rregulla dhe dispozita

Shkruan: Omer BERISHA

Fjala “bajram” është përkthim i fjalës “id”, por në gjuhën shqipe ajo ka kuptimin e festës. Fjala “id” rrjedh nga folja “ade-jeudu”, d.m.th. “kthehet dhe përsëritet”.

Festat gjenden ndër popuj qysh herët. Për çdo ngjarje madhështore ata caktojnë festë, ku i rikthejnë dhe i përsërisin kujtimet e tyre; dhe shfaqin gëzimin dhe ngazëllimin e tyre.

Por, pasi këto festa janë të caktuara nga vetë njerëzit, atëherë e kemi të qartë se ato do të kenë vetëm pamje

materiale e jo më shumë.

Allahu subhanehu ue teala, e begatoi këtë umet me *Fitër bajramin* dhe *Kurban bajramin*, festa në të cilat zgjerohen më tepër sesa në çështjet e dynjasë, por edhe afrohen tek Allahu me adhurime, duke shprehur falënderimin për të gjitha begatitë: që në Fitër bajramin ua mundësoi agjërimin – për të cilin luten t’ua bëjë kabull; ndërsa kurban bajramin që ua mundësoi t’i përfundojnë rregullat e haxhit apo therjen e kurbanit.

Tema

Kur erdhi i Dërguari salAllahu alejhi ue selem, në Medinë vërejti se atje kishin të caktuara dy ditë nga viti për të lozur dhe dëfryer dhe i pyeti për zanafillën e tyre. Ata u përgjigjën se këto ditë i kanë festuar që nga injoranca e hershme. Atëherë Resulullahu, sal-Allahu alejhi ue selem, u tha: *“Këto dy ditë Allahu ua ka zëvendësuar me dy ditë më të mira, dita e Kurban bajramit dhe ajo e Fitër bajramit”*.¹

Këto dy festa, Allahu i zbukuroi me namazin e bajramit, që njerëzit të afrohen dhe të njoftohen, t'i urojnë njëritjetrit bajramin dhe kështu tu shtohet dashuria dhe bashkimi.

Këto lloj tubimesh kanë aq mirësi të ahiretit, por edhe të kësaj bote, sa që na shtojnë edhe më bindjen se vetëm Islami është fe e vërtetë, të cilin Allahu e ka zbritur, që nëpërmjet tij njerëzit të arrijnë lumturinë, në këtë botë dhe tjetrën.

Dispozita e faljes së bajramit

Disa dijetarë kanë thënë se falja e namazit të bajramit është sunet i fortë (sunne muekkede), të tjerë kanë thënë se është farz kifaje, kështu që, nëse një grup besimtarësh e falin këtë namaz, të tjerët lirohen dhe nuk kanë përgjegjësi. Përkrahësit e këtij mendimi mbështeten kryesisht në argumentet e përgjithshme se besim-

tari ka vetëm pesë namaze të detyruara, jo më tepër, e sikur të themi se edhe bajrami është farz, atëherë ne do të shtojmë edhe një namaz, gjë që është e papranuar.

Mirëpo, mendimi më i vërtetë është mendimi i *Medhhebit Hanefij*, të cilin e ka miratuar edhe shejhul Islam Ibën Tejmije, se falja e namazit të bajramit është *farzi ajn*, pra, të gjithë besimtarët e kanë detyrë ta falin këtë namaz. Këtë mendim e mbështesin në ajetin:

“Falu dhe ther kurban për Zotin tënd” (Keuther 2). Në këtë ajet bëhet fjalë për namazin e bajramit dhe për kurbanin, të cilat me urdhër porositen të kryhen

dhe ai urdhër duhet respektuar përderisa nuk ka argument tjetër që do ta ulte peshën e këtij urdhri.

Po ashtu, e mbështesin edhe në hadithin e Umu Atije, Nusejba el-Ensarije, e cila rrëfen: *“Na ka urdhëruar Resulullahu sal-Allahu alejhi ue selem, që për namazet e bajramit t'i nxjerrim edhe vashat e reja dhe ato të voglat, ndërsa ato që janë në menstruacione të rrinë anash nga vendi i faljes së myslimanëve”*.

Në transmetim tjetër: *“Urdhëroheshim të dilnim për namazin e bajramit, madje t'i nxjerrim edhe beqaret nga shtëpia, e po ashtu edhe ato që janë në menstruacione, të cilat do të bëjnë tekbir me të tjerët, do të bëjnë lutje duke shpresuar bereqetin e kësaj dite dhe pastrimin nga mëkatet”*.²

Namazi i parë i bajramit që fali i Dërguari, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, ishte Fitër bajrami në vitin e dytë nga hixhreti.

¹ Sahih Ebu Davud 1134

² Tekstet e këtyre dy haditheve janë të përmendura sipas kuptimit, por ato bazohen në hadithit që i ka shënuar Buhariu, nr: 324, 980, 981 dhe 1652.

Këto argumente janë të pathyeshme në argumen-timin se ky namaz është farz ajn.

Forma e namazit të Bajramit

Koha e namazit të bajramit fillon pasi ngrihet dielli mirë, përafër-sisht 40 minuta pas lindjes së diellit.

Duhet theksuar se Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem, namazin e bajramit e falte në vend të hapur, ku tuboheshin të gjithë besimtarët dhe ky vend quhet musala – vendfalje. Posa arrinte aty dhe tuboheshin besimtarët, ai fillonte faljen e namazit të bajramit, ndërsa pastaj ligjëronte. Pra, hutbeja mbahet pasi të falet namazi. Këtë e mësojmë nga Abdullah b. Omeri, i cili rrëfen: “I Dërguari, salAllahu alejhi ue selem, Ebu Bekri dhe Omeri radijAllahu anhuma, e falnin namazin e bajrameve para hutbes”.³

Dëgjimi i hutbes është i pëlqyer, por nëse ndonjëri nuk qëndron për ta dëgjuar, sidomos nëse ka arsye, nuk ka asnjë përgjegjësi. Për këtë mbështetemi në fjalën e Abdullah b. Saib, njëri prej shokëve të të Dërguarit, salAllahu alejhi ue selem, i cili na rrëfen: “Kam falur namazin e Bajramit me të Dërguarin, i cili, pasi përfundoi namazin, tha: *Ne do të kemi ligjëratë (hutbe), kush dëshiron të qëndrojë për ta dëgjuar, le të qëndrojë, e kush dëshiron të shkojë, le të shkojë*”.⁴

Në Fitër bajram, tekbiret fillojnë nga momenti kur nisesh për në xhami. Në këtë mendim janë pajtuar katër imamët.

Cilat sure lexohen në këtë namaz

Namazi i bajramit i ka dy rekate. Ajo që më së tepërmi rrëfehët nga i Dërguari, salAllahu alejhi ue selem, është se ai në rekatin e parë të bajramit ka lexuar suren *el-A’la*, ndërsa në të dytin lexonte suren *el-Gashije*. Nu’man b. Beshiri thotë: I Dërguari, salAllahu alejhi ue selem, në bajram dhe në xhuma lexonte suret *Sebbihisme rabbikel a’la* dhe *Hel etake hadithul gashije*.⁵

Mirëpo, ndonjëherë lexonte edhe sure tjera. Kur Omeri radijAllahu anhu, e pyeti Ebu Vakid el-Lejthin se çka lexonte i Dërguari, salAllahu alejhi ue selem, në namazet e bajramit? Ai u përgjigj: Në dy rekatet e bajramit, ai lexonte suren *Kaf uel Kuranil mexhid* dhe *Ikterebetis sa’ah uen shekkal kamer*.⁶

Sa tekbire ka namazi i bajramit

Aisha radijAllahu anha, ka thënë: “*Sa u përket tekbireve të kurban dhe fitër bajramit është kështu, në rekatin e parë ka shtatë tekbire, ndërsa në të dytin pesë, pa i llogaritur tekbiret e rukusë*”.⁷

Nëse dikush vonohet dhe nuk i arrin të gjitha tekbiret, ai duhet të vazhdojë namazin me imamin dhe nuk ka nevojë t’i kompensojë këto tekbire, sepse ato janë sunet dhe jo vaxhib.

³ Buhariu 963

⁴ Albani në Irvaul Galil nr: 629 thotë se hadithi është sahih.

⁵ Muslimi nr: 878

⁶ Sahih Ebu Davud nr: 1154

⁷ Albani në Irvaul Galil nr: 639 thotë se hadithi është sahih.

Sa i përket asaj se çka duhet të thuhet në mes tekbireve, do të marrim për bazë atë që tregohet se, kur Abdullah b. Mes'udi u pyet për të njëjtën, u përgjigj: pasi thotë Allahu Ekber, e falënderon dhe lavdëron Allahu dhe dërgon përshëndetje për Resulullahun, salAllahu alejhi ue selem, pastaj thotë Allahu Ekber dhe përsëri e falënderon dhe lavdëron Allahu dhe dërgon përshëndetje për Resulullahun... kështu deri në fund.⁸

Gjera të pëlqyera për bajram

Larja e trupit

Imam Neveviu thotë se të gjithë dijetarët janë të mendimit se larja në këtë ditë, para se të shkohet për ta falë namazin e bajramit është e pëlqyer. Pasi e njëjta gjë porositet drejtpërsëdrejti nga Resulullahu salAllahu alejhi ue selem, për namazin e xhumasë, atëherë për namazin e bajramit kjo porosi me siguri është e dyfishuar. Pra, të kujdesemi që në këtë tubim të rrallë të shkojmë sa më të pastër.

Ngrënia para daljes

Prej gjërave të pëlqyera në Fitër bajram është të mos dalim nga shtëpia pa ngrënë diçka. Nëse duam të qëllojmë sunetin, atëherë hamë disa hurma, me numër tek, dhe nise-mi në vendin e caktuar (musala), ku

Nëse dikush vonohet dhe nuk i arrin të gjitha tekbiret, ai duhet të vazhdojë namazin me imamin dhe nuk ka nevojë t'i kompensojë këto tekbire, sepse ato janë sunet dhe jo vaxhib.

do ta falim bajramin. Enes b. Malik radijAllahu anhu, na rrëfen se *Resulullahu salAllahu alejhi ue selem, nuk nisej në namazin e Fitër bajramit përderisa nuk hante disa hurma dhe atë me numër tek.*⁹

Recitimi i tekbireve
Shkurtimisht nga fjalët e Ibën Tejmijes rahime-

hullah:

Mendimi më i vërtetë, të cilin e përkrahin shumica e dijetarëve të selefit por edhe të vonshmit është: tekbiret fillojnë nga sabahu i ditës së arafatit deri në iqindinë e ditës së fundit të bajramit (13 muharem), ndërsa në Fitër bajram, tekbiret fillojnë nga momenti kur nisesh për në xhami. Në këtë mendim janë pajtuar katër imamët.

Si thuhet tekbiri: forma më e transmetuar nga sahabët është: Allahu ekber, Allahu ekber, la ilahe il-lAllah, Allahu ekber. Allahu ekber ue lilahlil hamd.

Disa dijetarë e kanë pëlqyer që pas kësaj të thonë: La ilahe il-lAllah uehdehu la sherike leh, lekul mulku, ue lekul hamdu ue hue ala kuli shej'in kadir.

Veshja e rrobave më të bukura

Pasi është festë, tubim i rrallë dhe pamje e mrekullueshme, atëherë është e udhës që edhe ne të dukemi më së miri. Duhet të veshim rrobat më të mira që kemi dhe kështu të

⁸ Mexhmeuz zevaid 2/207

⁹ Buhari 953

pastruar dhe zbukuruar të takohemi me vëllezërit tanë. *Muhamedi salAllahu alejhi ue selem, kishte një xhybe të cilën e vishte veçanërisht ditëve të bajramit dhe në ditën e xhuma.*¹⁰

Ndërrimi i rrugëve

Kemi për qëllim shkuarjen në vendin e faljes nga një rrugë ndërsa kthimin nga rrugë tjetër. Xhabir b. Abdullah rrëfen: “Kur ishte ditë e Bajramit, i Dërguari salAllahu alejhi ue selem, ndërronte rrugët”.¹¹ Urtësinë e këtij veprimi një pjesë e dijetarëve e komentojnë duke thënë se këtë e bënte me qëllim që të dy rrugët të dëshmojnë për të në Ditën e Gjykimit, sepse atëherë çdo gjë do të flasë, edhe toka do të flasë se kush dhe çfarë të mire ka bërë mbi të; të tjerë thonë: këtë e ka bërë me qëllim që në çdo rrugë të vërehet kjo ditë; të tjerë thonë: këtë e bëri me qëllim që të shtojë mllëfin e armiqtve të Islamit; po ashtu kanë dhënë edhe komente tjera, por nuk ka asnjë pengesë që të gjitha ato të jenë të vërteta.

Për këto që thamë deri tani dhe të tjera, po sjell edhe fjalën e Ibën Kajjim el-Xheuziut, Allahu e mëshiroftë: “Bajramet i falte çdoherë në musala, ndërsa në xhami e ka falur vetëm njëherë, për shkak të shiut. Kur nisej për të falë këtë namaz, vishte rrobat më të mira që kishte. Në fitër bajram, para se të dilte, hante disa hurma, tek; ndërsa në kurban bajram nuk hante deri sa të

kthehej nga musala dhe hante nga kurban i që therte. Ai lahej për këto dy festa dhe shkante në këmbë. Kur shkante në musala, fillonte namazin pa ezan, pa ikamet dhe pa thënë: essalatu xhamiah. Pasi përfundonte namazin, kthehej nga njerëzit, të cilët qëndronin ulur, dhe i këshillonte. Fjalimin e tij e niste me falënderime dhe lavdërime për Allahun. Ai bëri lehtësim, duke e lënë besimtarin të zgjedhë, të qëndrojë për ta dëgjuar hutben ose të shkojë. Resulullahu salAllahu alejhi ue selem, praktikonte edhe këtë: kur

Këto argumente janë të pathyeshme në argumentimin se ky namaz është farz ajn.

kthehej prej musalasë, kthehej nga rrugë tjetër nga ajo që kishte ardhur.

Ndërsa dijetari Ibën Dekik thotë: Nuk ka divergjencë se namazi i bajramit është nga simbolet e kërkuara

fetarisht. Transmetimet lidhur me këtë janë të vërteta dhe nuk lënë asnjë dyshim. Namazi i parë i bajramit që fali i Dërguari, paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, ishte Fitër bajrami në vitin e dytë nga hixhreti.

Urimet e Bajramit

Shejhul Islam Ibën Tejmiut, i është parashtruar kjo pyetje: Urimi për bajramin, të cilin e përdorin shumica e njerëzve me fjalët: Me fat Bajramin, apo të ngjashme, a ka bazë në shariat ose jo? Nëse ka bazë, çka duhet të thuhet konkretisht?

¹⁰ Sahih Ibën Huzejme 1765

¹¹ Sahihul Buhari 986

Ai u përgjigj: Sa i përket urimit që i thuhet njëri-tjetrit në ditën e bajramit, sikurse: “tekabbelAllahu minna ue minkum - Allahu na i bëftë kabull” apo të ngjashme, themi se këtë gjë e kanë bërë edhe disa prej sahabëve, e po ashtu edhe disa prej imamëve të njohur, sikurse Imam Ahmedi dhe të tjerë. Mirëpo Imam Ahmedi ka thënë: Unë personalisht nuk e filloj urimin, por nëse dikush ma uron, atëherë ia kthej urimin, sepse përgjigjja ndaj urimit është vaxhib. Ndërsa, të fillosh urimin nuk është sunet i preferuar, por nuk është as e ndaluar. Kush uron ka ku mbështetet dhe kush nuk uron ka ku mbështetet. Allahu e di më së miri.¹²

¹² Mexhmuul Fetava 24/253

Fjala përfundimtare për urimin do të ishte kjo: Urimi në bazë është më afër traditës sesa adhurimit. Në çështjet e traditës themi se çdo gjë është e lejuar përderisa nuk e kundërshton asnjë tekst i sheriatit, gjë e cila nuk thuhet te adhurimet, sepse adhurimet e lejuara janë vetëm ato që janë sqaruar me tekste të sheriatit, e çdo adhurim tjetër është i refuzuar.

Ndërsa tradita dallon nga koha në kohë dhe nga vendi në vend. Ne të trojeve shqiptare e kemi traditë t’i themi njëri-tjetrit: “Me fat bajramin”; “Urime Bajramin”; “Për hair Bajramin”; “E gëzofsh Bajramin” etj.

“SadekAallahulAdhim”

Muhamed Xhemil Zejno

Disa nga lexuesit e Kur’anit famëlartë e kanë bërë shprehi që në fund të leximit të Kur’anit të thonë: SadekAllahuladhim, që do të thotë: Të vërtetën e ka thënë Allahu i madhërisëm. A duhet të thuhet kjo fjalë apo jo, duhet të shohim argumentet:

1- Kjo fjalë nuk është e transmetuar nga Muhamedi paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, as nga shokët e tij

e as nga tabiinët, por është shpikur nga gjeneratat e vonshme.

2- Leximi i Kur’anit është adhurim. Në adhurim nuk lejohet të shtohet asgjë. Këtë e themi duke u bazuar në hadithin e Muhamedit salallahu alejhi ue selem, ku thotë: “Kush shpik në fenë tonë çka nuk është prej saj, ajo është e pa pranuar (e refuzuar)”.

3- Ibni Mes’udi e ka dëgjuar Muhamedin salallahu alejhi ue selem,



duke lexuar Kur'anin deri sa arriti te ajeti “...e ty do të sjellim dëshmitarë mbi ata”. Nisa 41; nuk i tha “sadek Allahuladhim” e as që e urdhëroi që të thotë kështu por i tha: “*HASBUKE*” - *mjafton*. (Transmeton Buhariu).

4- Të vegjlit dhe ata që nuk kanë njuhuri mbi Kur'anin mendojnë se kjo fjalë është ajet nga Kur'ani; ata mendojnë se është ajet dhe mund ta lexojnë në namaz. Kjo gjë nuk lejohet, e sidomos në disa vende kur shkruhet ajeti në fund ia bashkëngjisin këtë fjalë.

5- Kur e kanë pyetur dijetarin e njohur Ibën Baz, ai ka thënë kjo nuk është tjetër pos risi (bidat) e shpikur nga njerëzit.

6- Fjala e Allahut të Madhëruar: “*Thuaj: Allahu e tha të vërtetën, prandiqeni fenë e pastër të Ibrahimit...*” (Ali Imran 94), është përgjigje ndaj çifutëve gënjeshtarë, argument është ajeti para këtij, ku thotë: “*Ai që, edhe pas kësaj shpif gënjeshtër kundër Allahut...*” (Ali Imran 93).

Muhamedi salallahu alejhi ue selem, e ka ditur këtë ajet. Por, megjithatë, nuk

e ka thënë pas leximit të Kur'anit e as shokët e tij nuk e kanë praktikuar një gjë të tillë.

7- Kjo risi e ka zhdukur Sunetin. Muhamedi paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi të, thotë “*Kush lexon Kur'anin le ta lusë Allahun me të*”.

8- Pasi të mbarojë leximin lexuesi, le ta lusë Allahun çka të dojë dhe atë (Kur'anin) le ta bëjë mjet për t'iu pranuar lutja, sepse kjo është vepër e mirë, e cila është shkak për t'iu pranuar lutja. E preferuar është që pas leximit të Kur'anit të lexohet kjo dua:

O zoti im, unë jam robi yt e biri i robit Tënd dhe i robëreshës Sate, balli im është në dorën Tënde. Dispozitat tuaja mbi mua i pranoj, i drejtë është gjykimi Yt mbi mua. Të lutem me çdo emër që ke emëruar Vetën Tënde ose që e ke zbritur në librin Tënd, apo ia ke mësuar dikujt prej krijesave të Tua, apo që e ke mbajtur të fshehur në diturinë Tënde, bëje Kur'anin pranverë të zemrës sime, dhe dritë të gjoksit tim, shndritje për pikëllimin dhe largim për dëshpërimin. Transmeton Ahmedi.

përktheu: ENVER AZIZI

Gruaja — mes liberalizmit ekstrem dhe radikalizmit të pa bazë

Dr. Salih b. Abdullah el-Humejd

Në kohën tonë, gruaja është nxjerrë nga shtëpia për të punuar, nxjerrje ekstreme pa kurrfarë mëshire për të.

Dijetarët, juristët si dhe mendimtarët vërtet dhanë një kontribut të çmueshëm rreth qartësimit të rrugës së drejtë për shoqërinë rreth kësaj çështjeje si dhe ua lehtësuan atyre që të gjejnë një metodë mesatare, e cila do të ishte e pranueshme në këtë çështje mjaftë serioze.

Njerëzit flasin sot pa ndërprerë rreth përmirësimit dhe hapjes së femrës me shoqërinë e saj. Rreth ngritjes dhe arsyetimit dhe hedhjen e kundërshtimeve anash.

Disa folës për këto çështje vërejmë tek ta se nuk i kanë kuptuar ato si duhet, flasin për metodologjinë mesatare, e cila do të ishte e mirë për të gjithë, mirëpo vërtet fjalët e tyre janë dëshpëruese, nuk janë gjithëpërfshirëse për vendet dhe pozitën në të cilën ata janë. Ata flasin me fjalë të cilat nuk e përthekojnë këtë temë ashtu siç e meriton ajo dhe si duhet të jetë.

Kemi nevojë për një media e cila është e dobishme dhe udhëzuese për këto çështje përmes së cilës femra do ta kuptonte rolin dhe rëndësinë e saj në shoqëri, do ta avanconte atë kah e dobishmja dhe do t'ia tregonte të drejtat e saj në mësim, detyra, përgjegjësi dhe vështirësi.

Andaj, duke e parë këtë gjendje, është obligim i dijetarëve, profesorëve dhe mendimtarëve që të ndërhyjnë, ndërhyrje urgjente për t'i qartësuar këto çështje, duke e treguar rrugën e vërtetë si dhe mënyrën e saktë dhe të vetme të cilën duhet pasuar në këto çështje.

Fatkeqësisht, disa që flasin për përmirësimin dhe hapjen me shoqërinë, qofshin ata prej mendimtarëve, juristëve (njerëzve të civilizimit) apo prej myslimanëve, ata prapë i keqkuptojnë këto gjëra apo i keqinterpretojnë dhe keq shprehen rreth tyre, qoftë kjo nga disa prej tyre qëllimisht apo jo.

Mirëpo, elhamdulillah, tek çdo besimtar ekziston bindje e sinqertë dhe besim i rrënjosur thellë në zemrën e tij se Islami i ka siguruar pasuesve të tij kënaqësinë dhe i ka vlerësuar në këtë botë si dhe ua ka siguruar shpërblimin në botën tjetër, kurdoherë që ata e pasojnë



Duke u nisur nga kjo filozofi dhe nga ky kuptim i gabuar i kësaj çështje, shumë nëna u larguan nga edukimi i fëmijëve të tyre, veten e vet e eksponuan për çdo kalimtarë, nderin e tyre e shkatërruan dhe turpin e tyre e zhdukën.

sheriatin e tij dhe sunnetin e të Dërguarit të Allahut, salAllahu alejhi ve selem.

Po ashtu, te myslimanët ekziston rregulli në të cilin ata besojnë dhe i cili është thellë i rrënjësuar në zemrat e tyre se ruajtja e fesë dhe

pasimi i saj nuk arrihet ndryshe veçse nëse besimtarët anojnë kah feja e tyre dhe e ndiejnë atë, gjë kjo e cila arrihet me besim të shëndoshë, pasim të sinkertë në rregullat e shariatit si me fjalë, ashtu edhe me vepra dhe besim.

Para këtyre rregullave statike Islame dhe para këtyre çështjeve të shumta të cilat vërtet janë të gjera për të folur për to, vërtet është e arsyeshme të zgjedhim vetëm një shembull prej gjithë asaj që flitet nëpër media. Shembulli ynë, që do ta tregonte metodologjinë mesatare, rrugën e drejtë dhe udhëzimin e vërtetë në këto pika do të ishte shembulli i gruas dhe të drejtat dhe problemet e saj.

Mesatare kjo që do të bashkonte mes ligjit të pastër të shariatit mbi këtë çështje dhe mes zakoneve nënçmuese

dhe pasimeve të verbëta. E cila do të tregojë si e konsideroi gruan shariatit në të kaluarën dhe si e konsideron ai sot, tregon mesataren e cila i dallon rregullat bazë dhe ato që janë të shariatit nga ato që nuk janë

prej tij, si dhe mohon çdo gjë e cila i është veshur shariatit për femrën në kohën tonë e nuk është pjesë e tij.

“Të drejtat e gruas” është fjalë të cilën vërtet e përdorin shumë folësit dhe folëset, përmes saj shumë prej tyre i zbukurojnë e disa të tjerë i rrisin fjalimet, faqet, thirrjet apo pretendimet e tyre. Sa e sa tubime dhe debate mbahen për një gjë të tillë. Por nëse i shikon ato çfarë mbajnë në vete do të shohësh se nuk ka asgjë në to dhe ke mundësi të flasësh për mangësitë e tyre pa ndalur. Madje, mund të vëresh se disa që mundohen t'i shërojnë këto probleme, mendimet e tyre nuk janë asgjë tjetër veçse devijim nga e vërteta, pretendime të tyre, pasim i epsheve, dhe anim nga ata dëshirojnë të anojnë. Ka prej tyre të

Gruaje dhe familja

cilët mendimet i përziejnë me dyfytërsi, përzierje apo fshehje të vërtetës.

Të drejtat e gruas apo të njeriut, në shkrimet e disa njerëzve ka paqartësi qoftë në qëllimin e tij apo në cakun që e synojnë. Për këtë shkak, si ata që i mbrojnë këto të drejta, edhe ata që i refuzojnë janë të njëjtë në humbjen e kohës nëpër debate dhe tubime të kota, të cilat nuk sjellin kurrfarë rezultati, por përkundrazi ua përziejnë të tjerëve këto të drejta dhe ua zhdukin të vërtetën para syve të tyre.

Edhe pse nuk ka kurrfarë dyshimi se gruaja ka të drejta ashtu siç ka edhe burri, gjithashtu ajo ka detyra sikurse burri. Është detyrë e patjetërsueshme mësimi dhe ndihma e gruas që t'i dijë të drejtat e saj, t'i arrijë ato dhe t'i ruajë ashtu siç duhet. Bile, prej mësimëve të saj fetare është se nuk konsiderohet lëvdatë nëse femra nuk i kërkon të drejtat e saj prej babait, vëllait apo burrit të vet. Është e vërtetë se burri është udhëheqës dhe përgjegjës por kjo nuk do të thotë assesi se kjo është diktaturë kundër saj, padrejtësi apo abuzim i të drejtave të saj.

Në vendet Islame vazhdimësia në një apo disa padrejtësi është obligim që të shikohet në to dhe t'i jepet rëndësia dhe koha e merituar. Vërtet gruaja sot vuan nga disa lloj padrejtësish dhe nënçmimesh, siç është lënia e saj pas dore, marrja e të drejtës së saj në bashkëjetesë, edukim, shtëpi të burrit të saj, shpenzime, të drejtë mirësjelljeje me të, duke mos hyrë në çështjen e nënçmimit dhe vlerësimit të saj.

Vërtet ka shpërdorim të pasurisë së saj, marrje të drejtës së saj në marrjen e vendimeve dhe konsultimin me të sidomos në çështjet që kanë të bëjnë me gruan apo janë çështje të posaçme të saj.

E drejtë e saj është drejtësia në ndarje (të gjërave), në ndarje të trashëgimisë, pasurive tjera, profesioneve, dhuratave etj. Ashtu siç na ka mësuar sheriatu ynë i pastër.

Këto janë disa të drejta që asaj i janë marrë, duke mos hyrë në të tjerat që janë edhe më të mëdha, siç janë, rrahja e saj, nënçmimi, mos mbajtja e as mos shkurorëzimi i saj, ashpërsi në biseda, marrje e të drejtës së edukimit të fëmijëve të saj, e sa e sa padrejtësi tjera të cilat ndodhin brenda mureve të shtëpive dhe pas mureve të oborrit.

Andaj, është obligim yni që ta ndihmojmë atë dhe ta inkurajojmë që të kërkojë të drejtat e saj duke ngritur zërin e kritikës tek ata që e dëgjojnë dhe janë të drejtë me të, qofshin ata të afërmit e saj, njerëz të mençur, gjykatës, përgjegjës apo udhëheqës.

Nënçmimi, lënia pas dore dhe mohimi i të drejtave të saj në shtëpi dhe shoqëri, duke mos hyrë në çështjen e nënçmimit dhe mohimit të të gjitha të drejtave të saj janë gjëra ndaj të cilave nuk guxojmë të heshtim e lere më të jemi të kënaqur apo t'i ndihmojë këto padrejtësi.

Kjo është një anë e problemit, por ka edhe anë tjera të cilat duhet t'i hedhim një vështrim. Ajo që thuhet me plot përgjegjësi dhe qartësi se Islami nuk e obligoi e as nuk e urdhëroi femrën të punojë jashtë shtëpisë së saj, kjo është më se e vërtetë, por ai as nuk e ndaloi nga puna jashtë shtëpisë së saj, nëse dëshiron një gjë të tillë; porse një gjë të tillë ia lejoi me rregullat e vendosura nga ai. Veproji kështu – pra e la të lirë dhe nuk e obligoi me punë jashtë shtëpisë, me qëllim që ajo mos të bjerë pre e sundimeve, e ideologjive, apo mos të robërohet e as të shfrytëzohet nga të

tjerët. Kjo që thamë ka nevojë për shtjellim më të gjerë. Nëse mendoni pak në atë që po ndodh sot, është se paraja është kriteri kryesor ndikues në botë, kurse në botën Islame ai e ka vendin e tij të merituar dhe është një prej ndikuesve, por jo kryesori. Kriteri ekonomik në botë sot është peshoja kryesore me të cilën maten gjërat, dhe përmes të cilit mundohen ta ndërtojnë botën e tyre, çka është bërë shkak për abuzim të shumë të drejtave dhe lënie pas dore dhe nënçmim, sidomos të femrës. Duke u nisur nga ky këndvështrim dhe botëkuptim, femra është e detyruar, qoftë si vajzë tek shtëpia e babait, qoftë si grua tek shtëpia e burrit, që të kujdeset për veten e saj. Kështu që dhënia pas këtij kriteri –parasë – këtë vend kaq të madh në shoqëri, i ka nxitur të gjithë, meshkuj dhe femra, që secili të vrapojë, qoftë edhe zvarrë, që të arrijnë mbledhjen e sa më shumë të hollave për të kaluar, sipas tyre, një jetë sa më të lumtur.

Çdo mashkull dhe femër, në këtë tollovi të madhe të interesave private duhet të vrapojë kah interesi i tij, nëse dëshiron t'i arrijë apo kalojë të tjerët në grumbullimin e pasurisë. Gjë kjo, e cila është shkak që femra qoftë vajzë apo grua, të vrapojë çdo mëngjes, si çdo njeri tjetër, për të arritur grumbullimin e pasurisë së saj, e cila do të jetë shkak për t'ia lehtësuar jetën dhe për të arritur kënaqësinë e saj. Bile, kanë krijuar në mentalitetin e saj idenë se është turp ajo të varet prej prindit dhe ata të

Bile, kanë krijuar në mentalitetin e saj idenë se është turp ajo të varet prej prindit dhe ata të punojnë për të që ta bindin deri në daljen prej shtëpisë, nga hamallëku dhe robotizimi. Krijuan bindjen se është turp të kujdeset burri për gruan e tij.

punojnë për të që ta bindin deri në daljen prej shtëpisë, nga hamallëku dhe robotizimi. Krijuan bindjen se është turp të kujdeset burri për gruan e tij.

Duke u nisur nga kjo filozofi e padrejtë, femra është e detyruar të dalë jashtë për të punuar dhe t'i harrojë ëndrrat e saj, dhe idenë që kish më parë, se burri apo babai do të kujdeseshin për të.

Dikush mund të thotë se një gjë e tillë ndodh tek jomuslimanët, por nëse i sheh disa intelektualë dhe pretendimet apo zgjidhjet e tyre për femrën, qoftë përmes debateve apo shkrimeve të tyre, do të vëresh se një bindje e tillë është krijuar edhe tek ta dhe thërrasin në një gjë të tillë dhe e konsiderojnë atë qëllim final dhe caku të cilin duhet femra patjetër ta arrijë. Them me plot përgjegjësi se, për fat të keq, dhënia pas grumbullimit të pasurisë dhe kërkesave të punës është bërë bazë e çdo përgjegjësie për secilin person në shoqëri, qofshin ata burra apo gra, pa marrë parasysh çfarë

pozite gëzojnë.

Krijimi i bindjes se pasuria është kriteri kryesor për çdo gjë ka qenë shkak për - deshën apo jo intelektualët - për shkatërrim të familjeve të tëra, humbje të lumturisë dhe e tronditi shoqërinë e qetë. Kjo ngase njeriu nuk mund të jetë i qetë përderisa nuk ka familjen e tij, kurse familja assesi nuk ka mundësi të krijohet apo të ekzistojë nëse nuk i jepet secilit prej anëtarëve të saj pozita dhe detyrat e merituar, qoftë ai burrë, grua

apo fëmijë. Duke u nisur nga kjo filozofi dhe nga ky kuptim i gabuar i kësaj çështje, shumë nëna u larguan nga edukimi i fëmijëve të tyre, veten e vet e eksponuan për çdo kalimtarë, nderin e tyre e shkatërruan dhe turpin e tyre e zhdukën.

O populli ynë, shikojeni këtë çështje me vërtetësi dhe seriozitet ashtu si i takon asaj. Gruaja në kohën tonë ka dalë nga shtëpia për punë, për ta fituar kafshatën e gojës, ngase kjo është e vetmja mënyrë për të mbijetuar, ajo e shfrytëzon çdo mundësi që i jepet për punë qoftë kjo edhe nëse nuk përputhet me natyrshmerinë e saj. Ngase nuk ka shumë mundësi që të zgjedhë, dhe është e detyruar t'i nënshtrohet ligjit të padrejtë të imponuar nga shoqëria. Nuk ka punë të cilën e punojnë burrat qoftë ata të fuqishmit prej tyre veçse do të gjen edhe femra të cilat e punojnë të njëjtën gjë.

Nëse shikojmë me syrin e realitetit, me sinqeritet dhe urtësi do të vërejmë se shoqëritë të cilat ia kanë hapur gruas dyert e punës jashtë shtëpisë dhe i janë nënshtuar një rregulli të tillë, këtë gjë e konsiderojnë lëvdatë e jo nënçmimi. Sheh gra të cilat e kanë humbur gjininë e tyre nga punët e rënda, punojnë ditën e natën, nëpër punët më të rënda fizike, nëpër rrugë, në kohët më të vështira, në diell, hënë e në yjet e natës, nëpër fabrika e kompani. Punë këto nga më të ndryshmet të cilat kur i sheh të rrëqethet lëkura dhe habiten me to intelektualët, njerëzit e mençur, të mëshirshmit dhe të sinqertët, (edhe pse ndoshta nuk

E drejtë e saj është drejtësia në ndarje (të gjërave), në ndarje të trashëgimisë, pasurive tjera, profesioneve, dhuratave etj. Ashtu siç na ka mësuar sheriatu ynë i pastër.

janë myslimanë), a thua çfarë mendon për myslimanët prej tyre. Këto janë disa nga shumë realitete të hidhura, e nëse realiteti i kësaj çështje është ashtu siç thamë atëherë a iu mbetet vend dhe a nuk është turp të flasin për të drejtat dhe problemet e femrës e pastaj tu japin kahje nga ata dëshirojnë apo zgjidhje të cilën epshet e tyre ua gjykojnë se janë të drejta apo duhet t'i binden sheriatit dhe ta pasojnë atë për t'i zgjidhur ato.

Ne kur flasim kemi për qëllim idetë e njeriut që është besimtarë dhe media që janë islame. Inteligjencë me kahje islame, e cila vrapon kah pastrimi i shoqërisë së tij nga rënia në gabimet në të cilat kanë rënë shoqëritë materialiste. Por kjo nuk arrihet ndryshe veçse duke e ndierë veten krenarë me fenë e vet dhe me plotësinë e saj si në çështjet e besimit, ashtu edhe në ato të legjislacionit, si në dituri, ashtu edhe në punë dhe në metodologji.

Është obligim dhe prej drejtësisë dhe ndershmërisë që të kërkojmë të flasin në këto çështje njerëz të cilët i kuptojnë këto gjëra dhe kanë kahje fetare i cili do të ketë mundësi të gjejë një zgjidhje të mirë e cila nuk është në kundërshtim me të kaluarën e as me të ardhmen, e cila do të kishte gjithashtu mundësi përfitimi prej përvojave dhe zgjidhjeve të tjerëve.

Kemi nevojë për një media e cila është e dobishme dhe udhëzuese për këto çështje përmes së cilës femra do ta kuptonte rolin dhe rëndësinë e saj në shoqëri, do ta avanconte atë kah e dobishmja dhe do t'ia tregonte të drejtat

e saj në mësim, detyra, përgjegjësi dhe vështirësi.

Media e udhëzuar e cila do t'i luftonte të gjitha mundësitë e shfrytëzimit të padrejtë të femrës, në çdo fushë të shfrytëzimit qoftë nderi i saj, autoriteti, të drejtat apo shfrytëzimi dhe tregtia me trupin dhe nderin e saj sikur të ishte pasuri si çdo pasuri tjetër të cilën e reklamojnë dhe e tregtojnë media.

Keni kujdes, kujdes që femrën mos ta hidhni në humnerat e humbjes, të nënçmimit dhe të marrjes së të drejtave. Kërkimi i të drejtës nga ai që i takon qoftë mashkull apo femër është e drejtë e secilit dhe duhet ndihmuar në gjetjen e tij si dhe duhet dhënë çdo kujt të drejtën e vet, mirëpo kjo e drejtë duhet kuptuar, duhet kërkuar dhe duhet gjetur sipas rregullave Islame dhe dispozitave të tij. Vetëm kështu arrihet baraspeshë e sigurt në çdo familje si dhe në shoqëri.

Sot te disa mjete të informimit vërehet qartë se disa njerëz gjatë fjalimeve apo edhe shkrimeve të tyre fusin dyshime se islami femrën e ka futur në robëri dhe larg nga të drejtat e saj pa marrë parasysh fushën e kësaj drejtësie. Mirëpo këta lloj njerëz flasin kështu ngase nuk ndiejnë përgjegjësi, e as nuk e ndiejnë veten si besimtarë dhe pjesëtarë të kësaj shoqërie, si dhe nuk kanë kurrfarë respekti për sheriatiin e tyre.

Andaj është obligim i shteteve islame, i shoqërive dhe personave të tij që ta largojnë këtë dyshim prej

Bile, prej mësimave të saj fetare është se nuk konsiderohet lëvdatë nëse femra nuk i kërkon të drejtat e saj prej babait, vëllait apo burrit të vet.

islamit si dhe tu japin mundësi pune femrave të shoqërive myslimane, duke pasur kujdes rregullat e vendosura nga sheriati.

Mirëpo edhe pse duket se dikush mundohet ta shëmtojë islamit përmes këtyre rasteve por në anën tjetër dijetarët, mendimtarët si

dhe intelektualët me mendje të shëndoshë arritën t'i zhdukun këto dyshime dhe mashtrime prej Islamit si dhe tu tregojnë të tjerëve rrugën e drejtë islame të cilën duhet pasuar në këtë çështje dhe në çështjet tjera.

Ata le të vazhdojnë në metodologjinë e tyre të drejtë dhe le ta shtojnë mundin sepse me ndihmën e Allahut dhe begatinë e Tij do t'ia arrijnë t'i kthejnë njerëzit në rrugën e drejtë, atë të Kuranit dhe Sunetit si dhe do t'ua mundësojnë përfitimin prej këtyre dy bazave të shariatit - përfitim ky që do t'u tregonte rrugën e drejtë e cila nuk ka në vete teprim e as nënçmim.

Kjo arrihet përmes studimit të çdo rasti të ri e pastaj kthimin e tij në baza të shariatit, studimin e tij, gjithashtu shikimi i zakoneve të çdo vendi dhe kthimi i tyre tek sheriati islam ku përmes tyre do të arrihet tek e vërteta e kërkuar, ngase në Islam gjërat e reja nuk janë të refuzuara në përgjithësi por ato vendosen në binarët e shëndoshë përmes shariatit. Gjithashtu në Islam pasimi nuk është ai që gjykon sheriatiin por sheriati e gjykon atë.

Përktheu:

Lulzim Susuri

"Të drejtat e gruas" është fjalë të cilën vërtet e përdorin shumë folësit dhe folëset, përmes saj shumë prej tyre i zbukurojnë e disa të tjerë i rrisin fjalimet, faqet, thirrjet apo pretendimet e tyre.

Harry Potter- një analizë islame e këtij fenomeni

Umu NUH

Magjia është një praktikë e vjetër njerëzore. Ndonjëherë është përkufizuar si mashtrim me paraqitjen e një diçkaje a një bashkësie njerëzish sipas një rrjedhe që është e kundërt me realitetin

Magjia është e njohur si mëkati i tretë më i madh pas shirkut dhe vrasjes, sipas Dhehebiut në librin e tij “*El Kabair*” (Mëkatet e mëdha).

Islami e konsideron magjinë si një blasfemi.

Allahu thotë:

“(e hodhën librin e Zotit) E ndoqën atë që thoshin djajtë në kohën e sundimit të Sulejmanit. Por Sulejmani nuk ishte i pafé, djajtë ishin të pafé, sepse u mësonin njerëzve magjinë. (Ndoqën) Edhe çka u zbriti në Babil dy engjëjve, Harutit dhe Marutit. E ata të dy nuk i mësonin askujt (magjinë) para se t’i thoshin: “Ne jemi vetëm sprovë, pra mos u bën i pafé!” E, mësonin (njerëzit) prej atyre dyve atë (magji) me çka ndanin burrin prej gruas së vet, por pa lejen e Allahut me atë askujt nuk mund t’i bënë dëm dhe ashtu mësonin çka u sillte dëm e nuk u sillte dobi atyre. E ata (çifutët) e kanë ditur se ai që (hodhi librin) e zgjodhi atë (magjinë), ai në botën tjetër nuk ka



ndonjë të drejtë (në mëshirën e Zotit). Po ta dinin, ata se për ç’ka e shitën vetveten, ajo është shumë e keqe.” (Sure Bekare: 102)

Në kërkimin tim për të arritur kuptimin më të mirë të atyre që lexojnë ose shikojnë gjëra që kanë të bëjnë me magjinë, isha shumë e befasuar të gjeja më shumë krishterë duke iu adresuar kësaj çështje sesa muslimanët. Në të vërtetë, nuk munda të gjeja një artikull lidhur me këtë çështje.

Dhe me nxjerrjen e fundit në shitje të

filmit 'Harry Potter', bile më shumë u mundova të gjeja një përgjigje të qartë. Kam dëgjuar argumentin: "Harry Potter është i mrekullueshëm, i inkurajon fëmijët të lexojnë"!

Natyrisht, leximi është diçka e rëndësishme, lidhur me këtë thotë Allahu në Librin e Tij:

"Lexo me emrin e Zotit tënd, i cili krijoi (çdo gjë). Krijoi njeriun prej një gjaku të ngjizur (në mitrën e nënës). Lexo! Se Zoti yt është më bujari! Ai që e mësoi (njeriun) të shkruaj me pendë." Sure Alek: 1-4.

Por, mos vallë mendoni se 'Harry Potter' është lloji i leximit që Allahu kishte për qëllim?

Pejgamberi, paqja dhe shpëtimi i Allahut qoftë mbi të, na tregon se arti i magjisë, shtrigëria dhe magjia janë mëkat dhe të dëmshme. Ai, paqja dhe shpëtimi i Zotit qoftë për të, thotë: "Janë tre që nuk do të hyjnë në xhenet: një i cili është i dhënë pas alkoolit, një i cili i ndërpret lidhjet familjare dhe një i cili beson në magji." (Ahmedi)

Dhe i Dërguari, salAllahu alejhi ue selem, thotë: "Shmanguni (largohuni) gjërave shkatërruese... ku përmendi shirkun dhe magjinë." (Buhariu)

Përfytyrimet imagjinare dhe fantazitë e mirë-shkruara mund të dëmtojnë shumë mendjen dhe memorien (kujtesën), sesa përvojat (përjetimet) aktuale ose të vërtetat.

I përcaktuar sipas një plani që të përziejë, trazojë, dhe të tronditë ndjenjat dhe të prodhojë një reagim të fortë emocional, një mit i mirë-planifikuar me karakteret tërheqëse, mund të jetë larg realitetit ditor veçanërisht kur fuqizohet

Mësojini fëmijëve tuaj veprat e Allahut dhe përgatitini ata të shohin realitetin përmes mësimëve të Allahut dhe të Dërguarit të Tij, paqja qoftë për të, dhe jo përmes perspektivës botërore.

përmes librave, lodrave, dhe lojërave të ndryshme përveç filmave. Nuk është çudi se shikuesit e zjarrtë të 'Harry Potter'-it i kanë numëruar ditët se kur do të shfaqet e do ta shohin magjinë, ilaçin dhe formulat magjike.

Fëmijët tanë kanë nevojë për natyrë të mirë morale për t'u identifikuar. Kur ata janë të mësuar të lexojnë dhe tani të shohin këtë fan-

tazi më ndryshe e perceptojnë, ne duhet ta pyesim veten si mbrojtësit dhe edukuesit e tyre, nëse këto janë llojet e shëmbëlltyrave që i duam për ata?!

Allahu thotë: "**O ju që besuat, ruani veten dhe familjen tuaj prej një zjarri, lënda djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët. Atë (zjarrin) e mbikëqyrin engjëj të rreptë e të ashpër që nuk e kundërshtojnë Allahun për asgjë që Ai i urdhëron dhe punojnë atë që janë të urdhëruar.**" Sure Tahrim: 6

Allahu na rikujton jetën tonë të shkurtë në këtë botë dhe nevojën që të zgjedhim të mirën mbi të keqen.

"Vërtet, jeta e kësaj bote është vetëm lojë e dëfrim, e nëse besoni dhe ruheni prej të këqijave, Ai u jep shpërblimin tuaj dhe nuk kërkon pre jush tërë pasurinë tuaj (por një pjesë)." Sure Muhammed: 36.

Me lejimin tonë që fëmijët tanë të shikojnë 'Harry Potter'-in, ne rrisim rrezikun që fëmijët të krijojnë një perceptim të shtrembër për shpirtrat, të cilat paraqiten si krijesa dhe simbole të ndryshme në ato tregime.

Të dhënë pas ndodhive mendjepërndezëse, ata absorbojnë vlerat e sugjeruara

dhe ruajnë e pajisen me imazhe “magjike” në mendjet e tyre, duke bërë botën të duket më okulte sesa ajo e përditshme.

Fantazitë argëtuese dhe zbavitjet strategjike kanë një mënyrë të veçantë të vlerave ndryshuese, besimet e komprometuara dhe ndërrimin e sjelljes tek adoleshentët si edhe te fëmijët.

Ky proces i mësimit ka qenë i emëruar “*edutainment*”, një rrugë e favorizuar të edukojë dhe të zbavitë në të njëjtën kohë, p.sh. ‘*Sesame Street*’ (rruga Susam).

Fuqia e saj të influencojë besimet dhe sjelljen është ilustruar nga firmat e marketingut të sotëm, të cilat shpenzojnë bilionë për reklamat interesante-zbavitëse që prekin emocionet, injorojnë faktet dhe motivojnë njerëzit që të blejnë produktin.

Kjo ‘idelogji’ e ‘*Harry Potter*’-it është një shembull i mirë, vjen komplet me tregtinë e kartelave, kompjuterëve dhe lojërave tjera të magjishme, rrobe, figura aksioni (luftuese) dhe kukullave që flenë fëmijët natën si edhe kaseta audio që mund ta mbajë mendjen e fëmijës të përqendruar për magjinë gjatë tërë ditës dhe natës. Tjetër është edhe ‘*Ouji Board*’- që është një tabelë me alfabet në të, dhe përdoret me një planshetë për t’i lexuar shkronjë për shkronjë ‘porositë e mbinatyrshme’

Mësojini fëmijëve tuaj veprat e Allahut dhe përgatitini ata të shohin realitetin përmes mësimeve të Allahut dhe të Dërguarit të Tij, paqja qoftë për të, dhe jo përmes perspektivës botërore.

Që t’ia dalim mbanë, duhet të jemi të vetëdijshëm nga ambienti rrethues në të

cilin gjenden.

A është e mundur të mbrojmë ata nga vlera të kundërta, jam e sigurt se nuk është. Sidoqoftë, është e mundur t’i ofrojmë atyre kuptime dhe arsytetime të qarta nga këto gjëra në dritën e Kur’anit dhe Sunetit.

Fillimisht ata duhet të mësohen të duan atë se çka Allahu do, dhe të urrejnë atë se çka Allahu e urren, dhe të shohin jetën nga Fjalët dhe Porositë e Tij.

Ata do të vërtetojnë mençurinë e tyre nga thënia e tyre “**JO**” ‘*Harry Potter*’it dhe të tillat si ai.

Pasi ta keni lexuar këtë artikull tani duhet t’i shihni gjërat më ndryshe. Nëse iu keni lejuar fëmijëve tuaj të lexojnë dhe të shohin materiale lidhur me magjinë, çka do të bëni tani për ta ndaluar atë?

Çdo familje është ndryshe, andaj trajtimi dhe qasja jonë për këtë çështje do të ndryshojë.

Ju duhet ta hiqni plotësisht atë, dhe të uleni me fëmijët tuaj për t’i shpjeguar situatën në detaje.

Ne jemi përgjegjës për atë se çka dimë lidhur me veprat tona të qëllimta.

Duke qenë një musliman, duhet gjithnjë të mësoh. Ne jemi gjithmonë duke u rritur dhe duke i ndryshuar pikëpamjet tona në mënyrë që ta njohim nevojën e Besimit dhe Fesë tonë se çfarë peshe ka në jetën e njeriut në veçanti dhe të shoqërisë në përgjithësi.

Allahu më udhëzoftë dhe më faltë nëse kam gabuar diçka që nuk iu kam referuar mësimeve të Tij, Ai është i Gjithëdijshmi dhe i Mëshirshmi.

Përshtati nga Anglishtja: Fitim Nuhiu

Fantazitë argëtuese dhe zbavitjet strategjike kanë një mënyrë të veçantë të vlerave ndryshuese, besimet e komprometuara dhe ndërrimin e sjelljes tek adoleshentët si edhe te fëmijët.



Gruaja e ditur e udhëzuar, krenaria e një populli

Shkruan: Valbona KELMENDI

Në mënyrë shumë të veçantë dhe me një kujdes shumë të denjë Zoti i Lartësuar flet për një grua besimtare dhe të devotshme, ku nga ky varg na këshillon që ta kemi model shembullin e saj:

“E atyre që besuan, Allahu u solli shembull gruan e Faraonit, kur ajo tha: “Zoti im, më bëj një vend pranë mëshirës Tënde në xhenet dhe më shpëto prej Faraonit e brutalitetit të tij, dhe më shpëto prej popullit mizor.” (Kur’an 66/11).

Nëse studiojmë gjendjen e kësaj gruaje besimtare, Asjes, kësaj gruaje mendjemprehtë, a nuk do të vijmë tek përgjigja se kjo grua ka qenë një grua e denjë, e mençur, e ndershme, vizionare, e shkathtë, e devotshme e mbi të gjitha besimtare e lidhur fort për besimin në Zotin Një?

Vërtet, një grua madhështore, me mençuri dhe trimëri të bashkëlidhura i tha burrit të saj (faraonit) në mënyrë të drejtpërdrejtë fjalën e drejtë për besimin që kishte ajo.

Gruaja dhe familja

Me gjithë torturat e rënda që përjetoi nga tirani i asaj kohe, të cilin e kishte burrë, Asjes nuk i bëri aspak përshlyetje luksit i tij, "kënaqësitë" e tij, që kjo t'i kthehej e të vazhdonte me të, sa që ai (faraoni) nuk e trajtoi as si marionetë të paktën, por e trajtoi si skllave, duke mos ia ndaluar torturat e njëpasnjëshme, por, përkundrazi ai (faraoni) me këtë i dha shansin dhe mundësinë që Asja të bëhet e nderuar tek Allahu, duke u bërë shëmbëlltë për të gjitha besimtarët deri në Ditën e Gjykimit.

Ndoshta mund të lindë pyetja: A mundemi edhe ne të bëjmë diçka madhështore siç bëri Asja? Pa dyshim që po, ngaqë njëra prej dhuntive të shumta të Allahut është që edhe mirësitë i ka lënë të llojllojshme.

Madje, atë që mund ta bëjë një grua me punët e saj të dobishme, nuk e bëjnë dot ligjëratat e leksionet e shumta.

Nëse je bijë, kujdesu për prindërit e tu, bëhu urë kaluese për ta me edukatën dhe moralin që ata të kultivuan, nëse je nënë, kujdesu për fëmijët e tu që t'i edukosh me edukatë të shëndoshë që në të ardhmen të bëhen barrikada të forta në mbrojtje të Islamit dhe të bëhen ndjekës të sinqertë të tij. Nëse je grua (bashkëshorte), bëhu e dashur dhe ndihmëse e sinqertë në çdo gjendje të bashkëshortit, me synim që të arrish kënaqësinë e Zotit, e nëse je gjyshe, bëhu e urtë dhe mbill urtinë tënde në brezat e rinj.

Me të gjitha këto virtyte mund të bëhemi lehtë krenaria e një populli, sepse Zoti ynë ka bërë që floriri ynë të

Mos të harrojmë se në këtë botë jeton edhe pronarja e pallatit edhe pronarja e kasolles, por neve na intereson të dimë se kush është e lumtur, kush jeton në lumturi?

jetë feja Islame, stolia jonë morali i lartë e pasuria të jetë karakteri ynë, ku këto të tria janë përbërës bazë për kënaqësitë e kësaj bote dhe amshueshmërisë.

Motër e nderuar !

Kjo botë me gjërat e saj kalimtare s'duhet të joshin mendjen tënde. Përkundrazi, ti duhet të jesh e lumtur vetëm kur

analizon vetitë e gruas besimtare dhe asaj jo besimtare.

Krahasoi këto dy dukuri të ndryshme, dhe do të shohësh se ti je me plot epërsi dhe e ngritur.

Mos të harrojmë se në këtë botë jeton edhe pronarja e pallatit edhe pronarja e kasolles, por neve na intereson të dimë se kush është e lumtur, kush jeton në lumturi?

Le të na mjaftojë një copë buke e thatë, e rreshkur, por hallall, sesa një gjellë me mishra të kombinuara por haram.

Të kujtojmë se shumë gra në botë janë të privuar nga begatitë që kemi ne.

A thua vallë janë të lumtura ato gra që zënë shtretërit e spitaleve nga sëmundjet e rënda (sida, droga etj.) , apo ato gra që gjenden prapa grilave të burgjeve për vepra penale degjeneruese, madje sa prej grave në botë e kanë të humbur kujtesën për shkak të dëshpërimeve në jetën e tyre?

Jo vetëm këta, por shembuj që nuk cekëm ka plot, lidhur me çfarë vuajnë gratë e joudhëzuara në Islam, prandaj bëhu falënderuese, sepse nder dhe privilegj më të lartë se udhëzimi i Zotit nuk ka.

Nuk themi që në mesin e grave të

udhëzuara nuk ka prej atyre që vuajnë nga sëmundje të ndryshme jo shëruese si kanceri, por besimtarja e sinqertë di se si ta trajtoj këtë gjendje, sepse sëmundjen e pranon si një mesazh përgëzues, ngaqë e di se me durim pastrohet nga mëkatet e bëra.

Gruaja inteligjente dhe e dashur di se si të jetë admiruese, ngaqë çdo vepër që bën e ka plotësisht të qartë se vetëm tek Allahu janë çelësat e botës dhe e fshehta e rehatisë dhe shpëtimit. Ajo në çdo çast mbjell një ide, në çdo orë një vepër të mirë e me këto gjëra vetëm se ia shton edhe më shumë krenarinë vetes së saj, familjes dhe popullit të saj.

Gruan besimtare, nëse e godet ndonjë sprovë si, humbja e fëmijës, bashkëshortit, prindit, vëllait, motrës, ajo di se si ta mbajë veten, ngaqë shembull ka elitën krenare të botës islame që lanë gjurmë të besimit, devotshmërisë, mirësisë, bujarisë e ato janë: Asja, Merjemja, Hatixhja, Aisheja, Esmaja, Fatimja, Rukaja etj...

Besimtarja e mençur e di që jeta përbëhet nga gëzimi, hareja, qetësia dhe kënaqësia, si dhe nuk lejon në zemrën e saj të ketë ankth, lakmi dhe zili, sepse e di që janë kundër shëndetit dhe bukurisë.

Gruaja e udhëzuar që është e kapur fortë te litari i Allahut është porsia blea që ushqehet mirë dhe jep vetëm të mira, saqë kurulet në bar nuk e thyen barin, kur e prek nektarin nuk e dëmton lulen, e jep mjaltin dhe nuk kafshon, fluturon dhe shkon me dashuri, zërin e ka përgëzues ku i ngjan

Nëse je grua (bashkëshorte), bëhu e dashur dhe ndihmëse e sinqertë në çdo gjendje të bashkëshortit, me synim që të arrish kënaqësinë e Zotit, e nëse je gjyshe, bëhu e urtë dhe mbill urtinë tënde në brezat e rinj.

një meleku dhe lë vetëm kënaqësi.

A thua vallë nuk janë këto karaktere dhe virtyte të larta që bulëzojnë dhe shpërndajnë vetëm krenari?

Ja vlen t'i shkoqisim disa shembuj madhështorë nga historia e grave të udhëzuara:

Në periudhën e Haxhaxhit, një nëne të shtyrë në moshë armiqte ia mbyllën djalin në burg, veç kësaj, armiqte e kërcënuan nënën besimtare se do t'ia vrisnin djalin. Pa u thyer dhe me plot vendosmëri burrërore, i tha: "Edhe po të mos e vrisni ju, do të vdesë vetë."

Pastaj shembulli i Esmas, bijës së Ebu bekrit, e cila kur e pa djalin e saj Abdullah b. Zubejrin të vlarë tha: "A erdhi koha që ky kalorës të bëhet burrë!?"

Mandej rasti me qëndrimin dhe mbajtjen e Hansajës kur mori lajmin e vdekjes së katër bijve të saj në flijim për besimin në Zotin Një, tha: "Falënderimi i takon Zotit që më respektoi me vrasjen e tyre si dëshmorë në rrugë të Tij".

Ndoshta, gjithsecila prej nesh, kur i përfytyron a sjell ndër mend këta shembuj, sheh t'i rrjedhin lot, dhe thotë se, butësia dhe urtësia e tyre i ngjajnë butësisë së erës së lehtë dhe qëndrueshmëria e tyre maleve të larta.

Nuk e mohojmë atë se edhe nga bota e grave të pa udhëzuara në Islam ka grata të afta dhe të guximshme, por duhet ta dimë se çfarë dallon mes atyre dhe të tjerave që janë të udhëzuara.

Të udhëzuarat, me plot vetëdije qëndrojnë në rrugën e cila të shpie në

kopshtet e lumturisë së përgjeshme, ndërsa gratë e tjera qëndrojnë në “kopshtet e lumturisë” për të pat llogari të majme bankare, rroba moderne, shërbime luksoze, shërbime nga shërbëtorët...etj. E këto janë gjëra vetëm për këtë botë kalimtare.

Ndër shkaqet e tjera të lumturisë që ka gruaja e udhëzuar, është edhe njohuritë shkencore krahas atyre fetare. Ajo me zgjuarsinë e saj mundohet që shtëpinë ta shndërrojë në një universitet të dashur me ambient joshës. Me kursimet që bën, ndërton një dhomë studimi me vitrina nga libri i shkencës dhe Kur’anotekës, duke dhënë shembull që nuk e shpenzon kohën kot si dëgjim muzike, shikim të serialeve të ndyra dhe të pa vlera, po e kalon dhe e shpenzon kohën e saj në vepra dhe gjëra të pranuar tek Allahu.

Jo rastësisht të urtët e kanë vlerësuar pozitën e gruas së ditur dhe të udhëzuar si më prestigjioze, duke e vendosur bukurinë e saj me bukuritë e universit. Me një kujdes të veçantë i përshkruajnë bukuritë e universit si, pamjen e llojllojshme të yjeve në qiellin e bukur, mandej, hënën e kthjellët që gjallëron duke thyer errësirën e natës etj. Bukuri këto, që syri i njeriut nuk i përkufizon nga gjerësia që kanë dhe shpirti kënaqet nga bukuritë që ato çlirojnë, por bukuria që jep gruaja e udhëzuar as nuk mund të krahasohet me bukuritë e universit.

Duke lënë këtë shkrim të pambyllur, për shkak që vlera e gruas besimtare i ngjan një oqeani që s’ka mbarim, po ndalemi tek një thënie e bukur që thotë: “Ndoshta për botën gruaja besimtare duket vetëm një person, por mos harrojmë se kjo grua në botë është më e vlefshme se vetë bota.”

“Kam harruar të martohem”

Gazeta egjiptiane “**El-Ahram**” botoi një artikull me titullin: **“Profesoresha e universitetit i këshillon studentet e saj të martohen”**. Në këtë artikull tregohet se si një profesoreshë universiteti në Angli ka qëndruar para qindra studentëve dhe studenteve dhe ka mbajtur një fjalim lamtumirës me rastin e daljes në pension.

Ajo tha: *“Ja, i plotësova gjashtëdhjetë vite të jetës sime. Kam arritur në kulmin e realizimeve, kam korrur sukses dhe kam avancuar çdo vit të jetës sime, kam realizuar punë të mëdha në shoqëri. Çdo minutë e ditës sime më ka sjellë fitime, arrita reputacion të madh dhe pasuri, m’u dha rasti të vizitoja tërë botën, por, a jam tani unë e lumtur pasi arrita gjithë këto fitore?”*



I teptisur me angazhime në mësimdhënie dhe arsim, në udhëtime dhe famë, harrova ta bëja atë që është më e rëndësishme se e tërë kjo për femrën... Harrova të martohem, të kem fëmijë dhe të stabilizohem në jetë. Për këtë jam kujtuar vetëm tani, kur erdha këtu para jush. Në këtë moment e ndjeva se nuk kam vepruar asgjë në jetën time dhe se i gjithë mundi që kam sakrifikuar gjatë tërë këtyre viteve është i humbur. Tani do të dal në pension, do të kalojnë një vit ose dy nga kjo kohë dhe pas kësaj të gjithë, të zhytur në preokupimet e tyre jetësore, do të më harrojnë... Po të isha martuar dhe të kisha formuar familje, do të lija efekte më të mëdha dhe më të mira në jetë.

Vërtet puna kryesore për femrën është që ajo të martohet, të krijojë familje dhe çfarëdo mundi tjetër që ajo sakrifikon në diçka tjetër nuk ka vlerë për jetën e saj në

esencë. Këshilloj çdo studente që këtë gjë ta vërë në prioritetet e saj, pas kësaj le të mendojë për punë dhe famë."

Vërtet këta njerëz shpenzojnë jetën e tyre dhe e kuptojnë realitetin vetëm pasi vijnë në përfundim të saj. Ajo që të çudit më shumë se kjo është kur sheh vajzat myslimane që tentojnë t'i pasojnë këta njerëz në këtë hutim. I lumtur është ai që mësohet nga të tjerët, prandaj për ku je nisur oj bijë e Islamit?

(Marrë nga libri: "Shëtitje në kopshtin e dijetarëve dhe të ngjarjeve të jetës", shkruar nga dr. Omer Eshkar)

Përktheu: Alaudin Abazi

Sadakatul fitri

(zekatul-fitri)

Sqarim: Këtë lloj lëmoshe e hasim me këto dy terme sadakatul-fitër dhe zekatul-fitër. Me sadaka e ka për qëllim lëmoshën, sepse është lëmoshë që u jepet të varfërve dhe nevojtarëve, ndërsa zekat d.m.th pastrim.

Përgjigjet: Ali Shaban TANUSHA

Pyetja e parë:

Çfarë dispozite në shariat ka zekatul-fitri?

Zekatul-fitri është vaxhib për çdo mysliman sipas hadithit të Ibën Abasit radijAllahu anhumu i cili thotë: *“Ia ka obliguar i dërguari i Allahut myslimanëve zekatul-fitrin një s’ aë’ me hurma, apo një s’ aë me drithë; për robin dhe të lirin, për mashkullin dhe femrën, për të voglin dhe të madhin dhe ka urdhëruar që të jepet para se të dalin njerëzit në namazin e bajramit”.*

Pyetja e dytë:

Ku qëndron urtësia e zekatul-fitrit? Zekatul-fitri, si lëmoshë është e veçantë në muajin e Ramazanit dhe duhet të jepet nga fundi i këtij muaji,

por edhe para se të mbarojë muaji, gjegjësisht para namazit të bajramit, ajo jepet për pastrimin e agjëruesit nga gabimet që ka bërë gjatë agjërimit. Kjo i ngjan namazit kur, pasi të japim selam themi tre herë estagfirullah [kërkoj falje prej Allahut] d.m.th. për gabimet dhe moskujdesin që bëjmë në namaz. Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem ka thënë: **“Zekatul-fitri është pastrim për agjëruesin prej fjalëve të kota, prej vulgarizmave dhe është lëmoshë për të varfrit [të mjerët]. Ai që e jep para namazit, është zekat i pranuar, e kush e jep pas namazit, atëherë ajo është lëmoshë si lëmoshat tjera”.** Hadithi është Hasen, shënon Ibën Maxhe dhe Ebu Davudi.

Në këndvështrim tjetër, themi se

¹ Sa’ë: Sasi e njohur në kohën e Resulullahut sal-Allahu alejhi ue selem, i cili është katër grushta.



fitrat jepen edhe për ata që nuk e kanë obligim agjërimit, si fëmijët, të sëmurët etj. Por edhe për foshnjën që ka lindur gjatë muajit të ramazanit. Kjo për të treguar se lëmosha është nga intuita dhe natyrshmëria e njeriut, pra edhe ata që pranojnë fitra, nëse u bëhen shumë, edhe ata japin, se nga urtësia e kësaj feje është që njeriu të jetë dorëdhënës e jo dorështrënguar.

Pyetja e tretë:

Kush e ka obligim të japë sadakatul-fitrin?

Obligim e ka çdo musliman i lirë që ka teprica nga furnizimi personal dhe të anëtarëve të familjes për një ditë e një natë, ose me fjalë tjera që ka më tepër nga ajo sasi që i del gjatë një muajit kur përpjesëtohet me numrin e

ditëve të muajit. E ka obligim për vete dhe për ata që ka obligim të kujdeset, si bashkëshorten, fëmijët e vet dhe shërbëtorët (nëse janë myslimanë).

İbën Omeri ka thënë: *“I dërguari i Allahut salAllahu alejhi ue selem ka urdhëruar sadakatul-fitrin të jepet për të voglin dhe të madhin; për të lirin dhe robin dhe ata për të cilët kujdeseni”*.

Pyetja e katërt:

Sa është sasia e zekatul-fitrit?

Sasia e obliguar për çdo person është gjysma e një sa'ut grurë, apo një sa'ut hurma, apo rrushit të thatë, apo elbit, apo djathit, apo diç tjetër që zë vendin e tyre si oriz, apo misër, apo tjetër gjë që llogaritet nga ushqimet thelbësore si i mjaftueshëm për racionin ditor.

Domethënë, me masën e kohës së sotme, sa dy kilogram nga sendet e përmendura, ose dy euro e gjysmë në person.

Pyetja e pestë:

Kur është koha e dhënies së zekatul-fitrit?

Sadakatul-fitri jepet nga fundi i ramazanit, para se të dalin besimtarët në namazin e bajramit. Përcillet nga Ibën Omeri se i dërguari salAllahu alejhi ue selem ka urdhëruar të jepet sadakatul-fitri para se besimtarët të dalin në namaz. D.m.th., kjo është koha e fundit, por mund të jepet edhe më parë. Nafiu rrëfen se Ibën Omeri ua ka dhënë atyre që e pranonin dhe atë para fitër bajramit një, apo dy ditë. (Buhariu 3\ 375).

Nuk lejohet të vonohet nga koha e vet pa arsye.

Ibn Abasi përcjellë se *Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem e ka obliguar zekatul-fitrin pastrim për agjëruesin nga fjalët e kota, nga vulgarizmat dhe është lëmshë për të varfrit [të mjerët]. Ai që e jep para namazit, ajo është zekat i pranuar, e kush e jep pas namazit, atëherë ajo është lëmshë si lëmshat tjera.*

Pyetja e gjashtë:

Kujt duhet t'i jepet?

Sadakatul-fitri nuk i jepet askujt përpos të varfërve dhe nevojtarëve që nuk përmbushin nevojat e tyre parësore, siç u përmend më parë në hadithin e cituar " ... është lëmshë për të varfrit ... ".

Pyetja e shtatë ?

A lejohet të jepet sadakatul-fitri në të holla që janë në vlerën e gjysmë sa'ut?

Sadakatul-fitri jepet ushqim dhe nuk bën të jepet në vlerën e saj të holla, pasi Pejgamberi salAllahu alejhi ue selem për zekatul-fitrin i ka cekur llojet e bazave ushqimore. Pra, në origjinë zekatul-fitri jepet ushqim e jo gjëra të tjera, ndërsa me të holla, ata që e pranojnë sadakatul-fitrin, mund të blejnë çmos po edhe gjëra të ndaluara, si cigare dhe gjëra tjera.

Nga dijetarët, **Ebu Hanifeja** rahimehullah e ka lejuar të jepet në vlerë, por kjo fetva e tij mund të shërbejë në kohën e sotme vetëm ashtu si do të përmend në përgjigjen vijuese.

Pyetja e tetë?

A bën të jepet sadakatul-fitri në institute fetare, bashkësi islame, apo organizata bamirëse, që pastaj ata ta shpërndajnë?

Lejohet të jepet në organe kompetente dhe organizata bamirëse sadakatul-fitri në sasi të përmendura dhe në vlerën e tyre në para, **por me kusht që të dihet me bindje të sigurt se ato do të shpërndahen në ushqim, dhe atë për të varfrit**, se përndryshe nuk lejohet. Allahu e di më së miri.

Në këtë rubrikë mirëpresim të gjitha pyetjet e juaja, ndërsa ato më interesante do të botohen. Pyetjet mund t'i dërgoni në albislam@gmail.com



Veprat që të nxjerrin nga Islami (2/2)

Shkruan: Agim BEKIRI

Vepra e gjashtë: Tallja me fenë e Allahut:

Allahu, subhanehu ve teal, thotë: “E nëse i pyet ata (përse tallen), do të thonë: “Ne vetëm jemi mah-nitur e dëfryer”. Thuaj: “A me Allahun, librin dhe të dërguarin e Tij talleni?” Mos kërkoni fare

ndjesë, ju pasi që (shpallët se) besuat, keni mohuar. Nëse një grupi nga ju i falim, grupin tjetër e dënojmë, ngase ishin kriminelë.” (Teube – 65,66)

Tallja me diçka prej fesë së Allahut, subhanehu ve teal, është kufër (mosbesim) sipas tërë dije-

Ilmihalili

tarëve, madje edhe nëse nuk e ka për qëllim talljen por thjeshtë dëshiron të bëjë shaka. Ibën Xheriri dhe dijetarë tjerë kanë shënuar rastin që e transmeton Abdullah b. Omeri se duke udhëtuar për në Tebuk një bashkudhëtar kishte thënë: “S’kemi parë si këta lexuesit tanë, lakmues të ushqimit, gënjeshtarë dhe frikacak më të mëdhenj. Një njeri që ishte afër tyre i tha: gënjen, nuk është ashtu porse ti je hipokrit! Gjithsesi do ta lajmëroj Pejgamberin, salAllahu alejhi ve selem. Kjo gjë i arriti Pejgamberit, zbritën ajetet kur’anore. Abdullah b. Omeri tregon: e kam parë (atë që tallej) si varej për yzengjitë e devesë së Pejgamberit kurse këmbët e tij përplaseshin për gurët dhe thoshte: “Ne vetëm jemi mahnitur e dëfryer” kurse Pejgamberi, salAllahu alejhi ve selem, përsëriste fjalën Kur’anore: **“A me Allahun, librin dhe të dërguarin e Tij talleni.”**

Kush tallet me diçka prej fesë, sikur me dijen e shariatit apo me ithtarët e tij, tallja me shpërblimin apo dënimin e Allahut, tallja me ata që urdhërojnë në të mirë dhe ndalojnë nga e keqja për shkak urdhrat dhe ndalesës së tyre, tallja me namazin qoftë me farzet apo nafilet, tallja me ata që kanë mjekra, apo me atë që s’punon me kamatë, ai është kafir.

Tallja me fenë e Allahut është cilësi e hipokritëve siç na ka treguar Allahu i Madhëruar: **“Mëkatarët ishin ata të cilët i përqeshnin ata që besuan. Dhe kur kalonin (besimtarët) pranë tyre (idhujtarëve), ata ia bënë me sy njëritjetrit. E kur ktheheshin te famil-**

jet e veta, ktheheshin të kënaqur. Dhe kur i shihnin ata (besimtarët), thoshin: “S’ka dyshim se këta (besimtarët) janë të humbur!” Po Ne, nuk i caktuam ata (idhujtarët) si roje të atyre (besimtarëve). E sot, (në ditën e gjykimit), ata që besuan do të tallen me jobesimtarët. Duke qëndruar të mbështetur (besimtarët) në kolltukë e duke shikuar. A thua a u shpërblyen jobesimtarët për atë që punuan?” (Mutafifin: 29-36)

Vepra e shtatë: magjia (sihri)

Kush bën sihër apo pajtohet me atë që bëjnë sihirbazët, ka ra në kufër. Allahu, subhanehu ve teala, thotë: **“E ata të dy nuk i mësonin askujt (magjinë) para se t’i thonë: “Ne jemi vetëm sprovë, pra mos u bën i pa fé!””** (Bekare – 102)

Në terminologjinë e shariatit sihri është: nje dhe lexime nëpërmjet të cilave magjistari arrin t’i shfrytëzojë shejtanët për ta dëmtuar atë për të cilin ka përgatitur sihrin.

Prej sihrit llogaritet edhe pengimi i njeriut për të dashur ndokënd (sarf) apo nxitjen e tij për të dashur (atf).

Parashtrohet pyetja: sihri a është i realët apo virtual?

Sipas Ehli Sunetit sihri është i realët dhe sikur të mos ishte i tillë Allahu, subhanehu ve teala, nuk do të na urdhëronte të kërkojmë mbrojtje nga magjistarët: **“Dhe prej dëmit të atyre që lidhin dhe fryjnë nyja.”** (Felek: 4)

“E, mësonin (njerëzit) prej atyre dyve atë (magji) me çka ndanin

burrin prej gruas” (Bekare: 102)

Sa i takon shërimit nga sihri ai bëhet vetëm me rukje, barna të lejuara dhe duke lutur Allahun. Në asnjë mënyrë nuk lejohet shërimi me siher duke shkuar te fallxhorët e magjistarët.

Vepra e tetë: Të ndihmosh jobesimtarët kundër besimtarëve:

Të ndihmosh jobesimtarët kundër besimtarëve është dalje nga feja, Allahu, subhanehu ve tealja, thotë: *“E kush prej jush i miqëson ata, ai është prej tyre”* (Maide: 51)

Është pyetur Abdullah b. Abdulatifi se kur ndihma ndaj jobesimtarëve është mosbesim? Është përgjigjur: kur t’i mbrosh ata, t’i ndihmosh me pasuri, me trup dhe me ide”.

Vepra e nëntë: Kush beson se disa njerëz kanë të drejtën për të dalë nga mësimet e shariatit:

Allahu, subhanehu ve tealja, thotë: *“Dhe se kjo është rruga (feja) Ime e drejtë (që e caktova për ju), pra përmbajuni kësaj, e mos ndiqni rrugë të tjera e t’ju ndajnë nga rruga e Tij. Këto janë porositë e Tij për ju, ashtu që të ruheni.”* (En’am: 153)

Transmeton Ahmedi. Ebu Davud et-Tajalisij dhe Darimiu nga Ibën Mes’udi, radijAllahu anhu se *“Pejgamberi, salAllahu alejhi ve selem, e bëri një vijë të gjatë dhe tha: kjo është rruga e Allahut, pastaj bëri disa viza djathtas dhe majtas dhe tha: këto janë rrugë përçarëse, në krye të çdonjërës prej*

tyre qëndron një shejtan i cili thërret në të, pastaj lexoi: “Dhe se kjo është rruga (feja) Ime e drejtë (që e caktova për ju), pra përmbajuni kësaj, e mos ndiqni rrugë të tjera e t’ju ndajnë nga rruga e Tij.”

Kush dëshiron të del nga sheriati apo mendon se s’ka nevojë për të, ka dalë prej feje.

Pejgamberi, salAllahu alejhi ve selem, ka thënë: *“I tërë ummeti im do të hyjë në Xhenet përpos atij që s’pranon! Thanë: o i Dërguar i Allahut, e kush nuk pranon? U përgjigj: kush më respekton mua do të hyjë në Xhenet e kush më kundërshton ai në fakt s’ka pranuar.”*

Në një rast tjetër Pejgamberi, salAllahu alejhi ve selem, ka thënë: *“Sikur Musa të ishte gjallë s’do të kishte pasur zgjidhje tjetër veç të më pasojë mua.”*

Vepra e dhjetë: T’ia kthesh shpinën fesë së Allahut, nuk e mëson dhe nuk vepron sipas saj:

Allahu, subhanehu ve tealja, thotë: *“E kush është më zullumqar se ai që këshillohet me ajetet e Zotit të vet, e pastaj u kthen shpinën atyre? Ne me siguri do të hakmerremi kundër kriminelëve.”* (Sexhde – 22)

Kjo do të thotë se çdonjëri i cili nuk interesohet për t’i mësuar bazat e fesë me të cilat bëhet musliman, në fakt ai ia ka kthyer shpinën fesë së Allahut dhe si i tillë ka ra në një vepër që llogaritet mosbesim.

“Mëkatet e mëdha”

Shkruan: **Sadat SHABANI**

Para pak kohe, shtëpia botuese “Nun” në Shkup botoi librin “Mëkatet e Mëdha”, nga autori Imam Dhehebi. Libri është përkthyer nga Ali Shabani, dhe ka gjithsej 255 faqe. Në fillim, përveç hyrjes së përkthyesit, recensuesit të origjinalit, gjendet edhe domethënia e termave, që është shumë e rëndësishme dhe është një hyrje e vogël në terminologjinë e hadithit, pastaj vijon edhe hyrja e vetë autorit, Imam Dhehebiut, Allahu e mëshiroftë.

Lipset shënuar se në origjinal libri është recensuar nga nxënësi i shejh Albanit, shejh Meshhur Selman, i cili jeton dhe vepron në Jordani.

Botimi i këtij libri në gjuhën shqipe na gëzoj pa masë për dy arsye:

E para, lexuesit shqiptar iu bë e mundur të ketë në dorë edhe një perlë nga thesari i dijetarëve të famshëm, pra, bëhet fjalë për një libër amzë në këtë lëmi, gjë që i begaton edhe më shumë bibliotekat e shumë myslimanëve që flasin gjuhën shqipe.

E Dytë, në vitet '90, ky libër u përk-



thye nga një student shqiptar në Medinë dhe na u dorëzua për botim. Duke dashur të bashkëpunojmë me institucionin e Bashkësisë Islame, përkthimin, së bashku me donacionin e disa bamirësve për botimin e këtij libri, ia dorëzuam këtij institucioni, me qëllim botimin dhe shpërndarjen e tij sa më të mirë. Mirëpo, i gjithë ky mund dështoi dhe u anashkalua, duke iu hequr disa nga temat e librit dhe duke mos patur kujdes në origjinalitetin e vet kësaj veprë fisnike.

Falënderojmë Allahun, e pastaj botuesit, që pas dhjetë viteve ky libër botohet në dritën më të mirë, çka na shtyn të mendojmë së është kryer një amanet siç duhet, duke shpresuar se në botimet e ardhme do të na begatojnë edhe me më shumë libra të këtij lloji. Allahu na i faltë gabimet dhe na bëftë prej atyre që kujdesen në përhapjen e së mirës dhe ndalimin nga e keqja.

Imam Dhehebiu:

Emri i tij i plotë është: Shemsuddin Muhammed b. Uthman b. Kajmaz et Turkmanij el Farikij ed Dimeshkij esh Shafij, i njohur si edhe Dhehebij.

Lindi në Damask në vitin 673 H. (1274 sipas Isaut). Mësoi përpara hoxhallarëve të Shamit, Egjiptit dhe Hixhazit (Saudisë së sotme). U shqua në shumë shkencë e në veçanti në Kiraetet (mënyrat e leximit) e Kur'anit, dhe në hadith saqë për hifdhin që kishte ai merrej si shembull dhe e atribuuan si "imami i të gjithëve në hifdh, shejhi i përmirësimit, dhe burri i burrave në çdo rrugë".

Zëri i tij u dëgjua në çdo vend dhe ia mësynë studentët nga të gjitha anët. Dhehebiu ka përmendur në "Mu'xhem"-in e tij se ai ka marr mësim nga më shumë se 300 mësues.

Dhehebiu ka ushtruar disa detyra në Damask, dhe kur u verbërua në vitin 741 H. e ndërpreu shkrimin dhe iu qas vetëm mësimdhënies derisa i erdh exheli.

Veprat e tij:

Dhehebiu -rahimehullah, ka lënë një pasuri të majme shkencore nga të cilat i përmendim:

1-Tarihul Islam (Historia Islame) nga lëmi i historisë,

2-Sijeru A'lami n Nubela, (Biografite e të shquarve fisnik), vepër voluminoze në të cilën me precizitet të enciklopedisë ka tubuar informatat mbi dijetarët dhe

Ky është një libër i dobishëm në fushën e vet. Është ndihmë (krah) i hatibit, ligjëruesit, vaizit, por edhe ngushëllim për të hutuarin dhe për të shqetësuarin. E zbut zemrën e vrazhdë, e largon nga lakmia nga gjërat e padobishme të dynjasë, është qortues i mëkateve dhe veprave shkatërruese.

njerëzit e shquar me ndikim në kohërat e tyre. 25 vëllime nga të cilët vëllimi i parë dhe i dyti janë jetëshkrimi i të Dërguarit, salAllahu alejhi ve selem.

3-El I'lamu bi Vefijjatil E'lam (Njoftim mbi vdekjet e të shquarve) nga lëmia e historisë,

4-El Iberu fi Ahbaril Beshher (Mësimet në lajmet e njerëzve) nga lëmia e historisë,

5-Tedhkiretul Huffadh (Përkujtimi i Hafizëve) biografi të dijetarëve,

6-Mizanul I'tidal fi Nakdir Rixhal (Peshoja e drejtësisë në kritikën e transmetuesve) vlerësim kritik i transmetuesve të hadithit,

7-El Mugni fidduafâ (I mjaftueshmi për njohjen e transmetuesve të dobët) libër i cili ka tubuar transmetuesit e dobët të hadithit,

8-El Kashif (Shpaluesi) biografite e transmetuesve shkurtimisht

9-Telhisul Mustedrek lil Hakim (Rezymimi i "Mustedrek"-ut të Hakimit) libër me vlerë të madhe në të cilën ai ka përmirësuar vlerësimet e gabuara të Imam Hakimit për shumë hadithe të cilët i ka shpallur si të sakta,

10-Tabakatu Meshahiril Kurrâ (Shtresat e Kurrâve-lexuesve të njohur të Kur'anit) biografite e lexuesve të njohur të Kur'anit,

11-Takvimul Buldan (Atlasi i Shteteve),

12-el Kebair (Mëkatet e mëdha) etj.

Po ja përcjell çka thotë recensuesi i botimit në arabisht shejh Meshhuri për këtë libër:

Ky është një libër i dobishëm në fushën e vet. Është ndihmë (krah) i hatibit, ligjëruesit, vaizit, por edhe ngushëllim për të hutuarin dhe për të shqetësuarin. E zbut zemrën e vrazhdë, e largon nga lakmia nga gjërat e padobishme të dynjasë, është qortues i mëkateve dhe veprave shkatërruese.

Megjithatë, ky libër është një nga gjurmët e imamit, prijësit të dijetarëve të hadithit, po edhe dijetar në xherh ve t'adil dhe për transmetuesit e haditheve.

Po ashtu, recensenti na tregon se çfarë pune ka bërë gjatë recensimit, ku thotë se:

Në recensimin e këtij libri jam angazhuar me:

1. rregullimin e teksteve ku i kam përmirësuar gabimet që kanë ndodhur aty duke u kthyer në veprat origjinale.

2. kam evidentuar dallimet e dorëshkrimeve.

3. kam kontrolluar të gjitha hadithet që janë përmendur në libër dhe kam treguar burimet e tyre në përmbledhjet e sunetit. Po ashtu kam treguar cilat janë sahih, të vërteta dhe cilat janë me të meta në suaza të rregulloreve të shkencës së hadithit.

4. kam sqaruar fjalët e pakuptueshme.

5. kam bërë radhitjen e Ajeteve, haditheve dhe ethereve sipas alfabetit.

Allahu e shpërbleftë për punën e bërë.

Në fund pashë të udhës t'i përcjellim lëvdatat e disa dijetarëve të mëdhenj për autorin e librit "mëkatet e mëdha"

Transmetohet nga shejhul-islam Ibën Haxher El-Askalani – Allahu e mëshiroftë – i cili ka thënë: Kam pirë ujë zemzemi

Falënderojmë Allahun, e pastaj botuesit, që pas dhjetë viteve ky libër botohet në dritën më të mirë, çka na shtyn të mendojmë së është kryer një amanet siç duhet, duke shpresuar se në botimet e ardhme do të na begatojnë edhe me më shumë libra të këtij lloji.

për ta arritur gradën e Dhehebiut në hifdh (të mbajturit mend përmendësh).

Ibën Kethiri ka thënë për të: ...te ai kanë diplomuar shumë dijetarë të hadithit dhe hafidhat...

Nxënësi i tij Et-Taxh Es-Subki, në "Shedheratudh-dheheb" ka thënë: "Sa i përket mësuesit tonë Ebu Abdullahut, ai ka qenë largpamës, nuk ka pasur rival. Ka qenë thesar i diturisë, te ai drejtoheshin kur kishin probleme enigmatike dhe misterioze. Ka qenë prijësi i umetit në të mbajturit mend, më i

çmuari i asaj epoke, dijetar eminent në "Xherh ve t'adil", burri i parë në mesin e transmetuesve. Sikur të ishte mbledhur umeti në një vend e të shikonin nga ai vend, e pastaj rrëfejnë për atë vendin lajmet e atyre që kanë prezantuar...

Sujuti në "Dhejlu tedhkiretil-hufadh" ka thënë: "Atë që e them, se të gjithë muhadithët janë nevojtarë në lëmin e transmetuesve dhe arteve tjera të hadithit për katër vetë: El-Mizzi, Edh-Dhehebi, El-Iraki dhe Ibën Haxheri"

Prej atyre që i thurën poezi ishte Et-Taxh Es-Subki me poezinë e tij:

Kush do të jetë tani për hadithin

dhe për ata që e kërkojnë atë

Pas vdekjes së imam hafidh Dhehebiut

Kush do të jetë për rivajetin

dhe lajmet kush do t'i shpërndajë

Në mesin e krijesave, arabë dhe joarabë

E lus Allahun t'i bën punët tona të sinkertë për Të, t'i regjistrojë në peshoren e veprave të mira në ditën kur nuk bën dobi pasuria e as bijtë, përveç atij që vjen me zemër të pastër.



*Redaksia e
Albislamit
të gjithë
besimtarëve ua
uron Fitër
Bajramin, e lutë
Allahun që
adhurimet të na
i pranojë, të na
shpërblejë ashtu
si di Ai,
subhanehu ue
teala dhe të na
jep sukses në
çdo të mirë.*



Flügger decor



**MADE IN
SCANDINAVIA**

**Since
1893**

www.fluegger.com

**F.A.G.com
+389(2)2600 154**